



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PËRMBAJTJA E RAPORTIT TË MONITORIMIT TË ZBATIMIT TË BUXHETIT VJETOR 2020

1. Informacion përmbledhës mbi buxhetin e vitit 2020
2. Realizimi i planit të të ardhurave për vitin 2020
3. Realizimi i planit të shpenzimeve për vitin 2020
 - 3.1 Realizimi i planit të shpenzimeve sipas klasifikimit buxhetor
 - Shpenzime personeli
 - Shpenzime operative dhe të mirëmbajtjes
 - Subvencione
 - Transferta korrente të brendshme
 - Transferta për buxhetet familjare dhe individë
 - Shpenzime kapitale të trupëzuara dhe të patrupëzuara
 - 3.2 Realizimi i planit të shpenzimeve sipas programeve buxhetore në njësitë shpenzuese :
 1. Bashkia Berat
 2. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike
 3. Ndërmarrja e Gjellbërimit
 4. Drejtoria e Arsimit
 5. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani”
 6. Qendra “Lira”
 7. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve , Ujërave dhe Shërbimit Veterinar
4. Raporti i detyrimeve të prapambetura
5. Treguesit kyç financiarë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

1. INFORMACION PËRMBLEDHËS MBI BUXHETIN 2020

Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ligjit Nr.68/2017 dt. 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, të Udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” , Buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2020 sipas VKB nr 66 dt. 26.12.2019, i konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresë nr 1580/4 prot datë 13.01.2020, Bashkia Berat ka hartuar raportin e tretë të monitorimit të buxhetit të vitit 2020 , raport i cili informon së pari Këshillin e Bashkisë Berat dhe më tej qytetarët mbi përmbushjen e qëllimeve dhe të objektivave të Administratës së Bashkisë Berat, mbi përdorimin e fondeve publike, në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet për garantimin e qëndrueshmërisë së sistemit të menaxhimit financiar të Bashkisë Berat për vitin 2020.

Bashkia Berat miratoi buxhetin e vitit 2020 me VKB nr. 66 datë 26.12.2019 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr. 1580/4 prot. datë 13.01.2020. Buxheti fillestar 1,075,270,000 lekë.

Me VKB nr. 14 datë 27.02.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 189/1 prot. datë 03.03.2020, u miratua shtesa e buxhetit të bashkisë me 58,316,662 lekë , për të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020.

Me VKB nr. 58 datë 30.09.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat u miratua shtesa në buxhet me 1,216,741 lekë, për vlerën e garancisë së punimeve të objektit Rikonstruksion i shkollës “Thimi Tane” .

Plani i Buxhetit të vitit 2020 me shtesat e ndryshimet është 1,134,803,403 lekë .

Objektivi i përgjithshëm i buxhetit 2020 : Menaxhimi korrekt i financave vendore, siguri i përdorimit të fondeve publike në respektim të parimeve të ekonomicitetit, efikasitetit dhe efektivitetit , në funksion të realizimit të misionit të bashkisë, në zbatim të VKB nr. 66 date 26.12.2019, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2020 dhe PBA Përfundimtare 2020-2022 ”, i ndryshuar, si dhe gjithë akteve ligjore dhe nënligjore në fushën e menaxhimit të financave vendore, por jo vetëm.

Disa nga objektivat kryesore të zbatimit të buxhetit të bashkisë Berat :

- ✓ Realizimi i planit të të ardhurave nga Taksat dhe Tarifatat vendore, duke maksimizuar arkëtimet prej tyre, nëpërmjet shtimit të bazës së taksapaguesve, (shtimit të numrit të tatim paguesve), dhe jo nëpërmjet rritjes së nivelit të taksimit, porveç atyre të ndryshuara me akte ligjore.
- ✓ Realizimi i shpenzimeve sipas programeve buxhetore të miratuara me VKB.
- ✓ Shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe moskrijimin e detyrimeve të reja

Në kapitujt vijues do të relatohet mbi realizimin e objektivave dhe të produkteve kundrejt planifikimit vjetor duke përgatitur Raportin vjetor të monitorimit të zbatimit të buxhetit të vitit 2020 sipas standardeve të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të zbatimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E REALIZIMIT TË BUXHETIT 2020

në 000 Lekë

Përshkrimi	Buxheti fillestar 2020	Buxheti i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Realizimi në %
Totali i të ardhurave	1,075,270	1,134,803	937,406	82.6%
Total Transferta	547,061	583,448	583,449	100.0%
Transferta e pakushtëzuar	293,099	293,099	293,099	100.0%
Transf. e pakushtëzuar trashëguar nga viti paraardhës	0	5,905	5,905	100.0%
Transferta Specifike	253,962	253,962	253,962	100.0%
Transf. e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	0	30,482	30,482	100.0%
Total të ardhura të veta	528,209	551,355	353,957	64.2%
Të ardhura të veta	528,209	529,426	332,028	62.7%
Të ardhura të veta trashëguar nga viti paraardhës	0	21,929	21,929	100.0%
Totali i Shpenzimeve	1,075,270	1,134,803	816,588	72.0%
Total shpenzime operative (korrente)	901,816	960,132	727,300	75.8%
Shpenzime personeli	514,286	513,936	465,890	90.7%
Shp.operative, & mirëmbajtje & të tjera transf.	387,530	446,196	261,410	58.6%
Shpenzime kapitale	173,454	174,671	89,288	51.1%

Të ardhura të papërdorura që trashëgohen në vitin pasardhës	120,818
Transferta e pakushtëzuar	27,742
Transferta Specifike	47,245
Të ardhura të veta	45,831

Siç shihet nga të dhënat e pasqyrës së mësipërme :

- **Të ardhurat** janë realizuar në total në shumën **937,406 mijë lekë** , ose në masën **82.6%** , nga të cilat realizimi i të ardhurave të veta është 62,7% apo në vlerë 332,028 mijë lekë kundrejt 529,406 mijë lekë të planifikuara.
- **Shpenzimet** janë realizuar në total në shumën **816,588 mijë lekë** ose në masën **72%**, nga të cilat shpenzime personeli realizuar në masën 90,7%, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes realizuar në masën 58,6% dhe shpenzimet kapitale realizuar në masën 51,1%.
- **Të ardhura të papërdorura** në vitin 2020 që trashëgohen në vitin 2021 janë në shumën **120,818 mijë lekë**, të cilat përbëhen specifikisht nga :
 - a. Transferta e pakushtëzuar sektoriale specifike47,244,788 Lekë
 - b. Transferta e pakushtëzuar e përgjithshme.....27,742,343 Lekë
 - c. Të ardhurat lokale 45,831,677 Lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PASQYRË PËRMBLEDHËSE E REALIZIMIT TË BUXHETIT VITET 2019 & 2020

në 000/lekë

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar 2019	Realizimi faktik 2019	Realizimi në %	Buxheti i rishikuar 2020	Realizimi faktik 2020	Realizimi në %
Totali i të ardhurave	1,168,760	962,625	82.4%	1,134,803	937,406	82.61%
Total Transferta	642,893	642,893	100.0%	583,448	583,449	100.0%
Transferta e pakushtëzuar	290,474	290,474	100.0%	293,099	293,099	100.0%
Transf. e pakushtëzuar trashëguar nga viti paraardhës	46,679	46,679	100.0%	5,905	5,905	100.0%
Transferta Specifike	253,727	253,727	100.0%	253,962	253,962	100.0%
Transf. e Specifike trashëguar nga viti paraardhës	52,013	52,013	100.0%	30,482	30,482	100.0%
Total të ardhura të veta	525,867	319,732	60.8%	551,355	353,957	64.2%
Të ardhura të veta	503,966	297,831	59.1%	529,426	332,028	62.7%
Të ardhura të veta trashëguar nga viti paraardhës	21,901	21,901	100.0%	21,929	21,929	100.0%
Totali i Shpenzimeve	1,168,760	904,307	77.4%	1,134,803	816,588	72.0%
Total shpenzime operative (korrente)	796,299	659,046	82.8%	960,132	727,300	75.8%
Shpenzime personeli	508,176	479,787	94.4%	513,936	465,890	90.7%
Shp.operative, & mirëmbajtje & të tjera transf.	288,123	179,259	62.2%	446,196	261,410	58.6%
Shpenzime kapitale	372,461	245,261	65.8%	174,671	89,288	51.1%

Bashkia Berat që nga viti 2016 siguron ofrimin e shërbimeve publike, sociale, komunitare, etj, nëpërmjet 7 Njësive Shpenzuese, të cilat menaxhojnë buxhetin në programet përkatëse :

1. Bashkia Berat menaxhon 50% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
2. Ndërmarrja e Gjellbërimit menaxhon 4% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
3. Ndërmarrja e Shërbimeve Publike menaxhon 10% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
4. Drejtoria e Arsimit menaxhon 26% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
5. Qendra Kulturore “Margarita Tutulani” menaxhon 4% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
6. Qendra “Lira” menaxhon 2% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020
7. Drejtoria e Bujqësisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar menaxhon 4% të totalit të buxhetit të bashkisë v.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi i shpenzimeve në total për Bashkinë Berat sipas njësive shpenzuese për vitet 2019 & 2020 paraqitet si më poshtë :

në 000/lek

Nr	Njësia Shpenzuese	Buxheti i rishikuar 2019	% në strukturë	Fakt 2019	% e realizimit	Buxheti i rishikuar 2020	% në strukturë	Fakt 2020	% e realizimit
1	Bashkia Berat (Aparati)	642,202	55%	450,624	70%	562,318	50%	364,856	65%
2	Ndërmarrja e Gjellbërimit	39,040	3%	36,301	93%	42,394	4%	34,433	81%
3	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	92,706	8%	70,432	76%	113,846	10%	96,248	85%
4	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	290,400	25%	254,508	88%	298,247	26%	230,143	77%
5	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	39,836	3%	32,071	81%	45,582	4%	28,142	62%
6	Qendra LIRA	25,187	2%	24,320	97%	26,595	2%	23,701	89%
7	Drejtoria e Bujqësisë	39,389	3%	36,051	92%	45,821	4%	39,065	85%
	Total	1,168,760	100%	904,307	77%	1,134,803	100%	816,588	72%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2. REALIZIMI I PLANIT TË TË ARDHURAVE PËR VITIN 2020

Viti financiar 2020 është viti i ngarkesave të mëdha që sollën për pasojë dhe ndikim në realizimin e planit të të ardhurave.

Në këto kushte vetë plani i të ardhurave u ndryshua gjatë vitit për t'u përshtatur me kushtet e reja të krijuara.

Referuar të dhënave përfundimtare kemi këto tregues: në 000 lekë

Nr.	Emërtimi	Plani Fillestar 2020	Plani Ndryshuar 2020	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne % Kundrejt Planit Fillestar
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	5,800	6,344	7,051	122%
II	Të ardhura nga tatimi mbi të ardhurat personale	4,619	-	13,043	282%
III	Taksat vendore	165,754	113,185	128,668	78%
IV	Tarifat vendore	235,485	153,574	153,818	65%
V	Tarifa të Drejtorisë Bujëqsisë, Administrimit të Pyjeve, Ujërave dhe Shërbimit Veterinar	4,600	3,109	2,006	44%
VI	Tarifa të Drejtorisë Ekonomike të Arsimit	19,946	9,698	11,194	56%
VII	Të ardhura të tjera	92,005	32,664	17,602	19%
VIII	Të ardhura nga MZSH	350	178	206	59%
TOTALI		528,209	318,752	333,588	63%

Të dhënat e pasqyrës së mësipërme tregojnë realizimin e të ardhurave sipas zërave kryesorë të të ardhurave. Në plotësim të këtyre të dhënave trajtojmë gjerësisht dhe treguesit përcaktues si në plan dhe në faktin e realizuar, ndër më të rëndësishmit citojmë : numri e bizneseve sipas llojit, sipas vendodhjes gjeografike dhe të dhëna të tjera strukturore të tyre. Kjo për të njohur faktorët bazë që ndikojnë në realizimin e planit të të ardhurave.

Në qytetin e Beratit për vitin 2020 kanë ushtruar aktivitetin ekonomik 2231 biznese dhe 43 Institucione
- Në njësinë administrative Berat për vitin 2020 ushtrojnë aktivitetin ekonomik 1,730 biznese dhe 43 institucione, nga të cilat:

a.Njësi tregtare biznes i vogël: 1,316 biznese nga të cilat:

Njësi tregtare biznes i vogël	1,316
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	28
Prodhim	81
Shitje me pakicë	444
Bar – Kafe	178
Ushqimore	105
Profesione të lira	116
Shërbime	263
Transport	67
Ambulant	34

b.Njësi tregtare biznes i madh 414 biznese nga të cilat:

Njësi tregtare biznes i madh	414
Transport	81
Import eksport	243
Prodhim	38
Ndërtim	25
Banka	11
OJF	16



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

c. Institucione 43

- Në njësitë administrative bizneset të mëdha dhe të vogla janë si më poshtë:

Njësia Administrative Otllak

Njësi tregtare biznes i vogël dhe i madh :

Njësi tregtare biznes i vogël	209
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	12
Prodhim	21
Shitje me pakicë	71
Bar - Kafe	47
Ushqimore	2
Profesione të lira avokate noter stomatolog përmbartues kabinet mjekësor dhe dentar	1
Profesione të lira të tjera	33
Shërbime	26
Transport	29
Njësi tregtare biznes i madh	64
Import eksport	46
Prodhim	9
Ndërtim	4
Përpunim guri	5

Njësia Administrative Velabisht

Njësi tregtare biznes i vogël dhe i madh :

Njësi tregtare biznes i vogël	138
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	2
Prodhim	19
Shitje me pakicë	72
Bar - Kafe	15
Profesione të lira të tjera	2
Shërbime	13
Transport	16
Ambulant	1
Njësi tregtare biznes i madh	12
Import eksport	10
Prodhim	2

Njësia Administrative Sinjë

Njësi tregtare biznes i vogël dhe i madh :

Njësi tregtare biznes i vogël	24
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	8
Prodhim	3
Shitje me pakicë	8
Profesione të lira të tjera	1
Transport	5
Njësi tregtare biznes i madh	16
Import eksport	13
Ndërtim/Përpunim guri	1
Përpunim guri	2



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Njësia Administrative Roshnik

Njësi tregtare biznes i vogël dhe i madh :

Njësi tregtare biznes i vogël	34
Restorant, ushqim i shpejtë, piceri	2
Prodhim	2
Shitje me pakicë	12
Bar - Kafe	2
Shërbime	3
Transport	13
Njësi tregtare biznes i madh	4
Prodhim	4

- Analiza e realizimit të planit të të ardhurave

Planifikimi fillestar në plan buxhetin e vitit 2020 ishte gjithsej 528,209,000 leke të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë Berat përfshirë dhe njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otlak, dhe institucioneve të vartësisë.

I karakterizuar nga problematikat që kishte, viti financiar 2020 natyrshëm solli dhe pasojat që ndikuan në realizimin e treguesve të tij ekonomik.

Në krahun e të ardhurave, faktorët ndikues sidomos në 6-mujorin e parë ndikuan negativisht në realizimin e objektivave të planifikuar. Për rrjedhim, referuar të dhënave përfundimtare, realizimi i të ardhurave në total, kundrejt objektivave ishte në nivelin 63%, ose 318,752,000 lekë, me një mosrealizim në shumën 209,457,000 lekë.

Ndikimin më të madh në këtë realizim dhe mosrealizim u ndie kryesisht në zërat, të cilat trajtojmë në këtë material, dhe në total kanë një efekt në mosrealizimin e të ardhurave – 37 % të planit të të ardhurave totale të vitit 2020.

Indikatori i realizimit të planit në nivelin e 63% , ose mos realizimi në indikatorin – 37 % vjen si rezultat :

- Faljeve të tarifave taksave dhe tarifave vendore.
- Mungesa e likuiditetit nga biznesit si efekt i mbylljes tre mujore si pasojë e situatës pandemike.
- Ndryshimi strukturor i biznesit brenda llojit dhe nga njëri grup në tjetrin, kjo përshtatur me situatën e krijuar.

Për rrjedhim kemi :

- Në total kundrejt realizimit faktik të vitit 2019 prej 307,716,000 lekë, të ardhurat e vitit 2020 janë me realizim prej + 11,036,000 me shumë se realizimi i vitit të kaluar.

Ka një mosrealizim për taksat dhe tarifat vendore pasi situata e krijuar si pasojë e pandemisë së COVID – 19 solli një mbyllje të aktivitetit për shumë njësi tregëtare.

Bashkia Berat nëpërmjet Këshillit Bashkiak me vendimin nr.33 datë 22.05.2020 fali tarifat për një kategori të caktuar të subjekteve për një afat kohor në mënyrë që të mbështesë zhvillimin e biznesit, duke lehtësuar sadopak paaftësinë paguese të krijuar për këtë periudhë dhe për ti dhënë frymëmarrje biznesit në Bashkinë Berat.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Të ardhurat nga taksat vendore

Përgjithësisht zërat e taksave vendore kanë pasur një realizim 78% të vlerës së planifikuar, ku vlen të përmendim:

Nr.	Emërtimi	Plani Fillestar 2020	Plani Ndryshuar 2020	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne % Kundrejt Planit Fillestar	Realizimi ne % Kundrejt Planit te Ndryshuar
III	Taksat vendore	165,754	113,185	128,668	78%	114%
1	Takse tabele	3,484	2,795	3,007	86%	108%
•	Tabelë për qëllime identifikimi	2,166	2,057	2,141	99%	104%
•	Tabelë për qëllime reklamimi	1,318	738	866	66%	117%
2	Te ardhura nga zënia e hapësirave publike	18,252	6,388	8,425	46%	132%
3	Takse e Drejtorise te Planifikim Territorit	28,735	18,000	18,256	64%	101%
•	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	28,735	18,000	18,256	64%	101%
4	Takse fjetje ne hotel	4,595	827	750	16%	91%
5	Takse mbi token bujqesore	18,595	12,645	15,120	81%	120%
6	Takse e mjeteve te perdorura	27,391	20,543	30,019	110%	146%
7	Takse e kalimiti te drejtes se pronsise(ZRPP)	2,521	3,815	4,260	169%	112%
8	Takse mbi ndertesat	54,191	42,269	42,299	78%	100%
9	Takse trualli	7,976	5,902	6,532	82%	111%
10	Te tjera taksa	16	-	-	0%	0%

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë taksa e ndikimit në infrastrukturë, taksa mbi ndërtesat, mbi truallin, Taksa e tabelës, Taksë fjetje në hotel, të ardhurat nga zënies së hapësirave publike, taksa mbi token bujqësore, taksa e mjeteve të përdorura, taksa mbi ndërtesat dhe trualli.

1. Taksa mbi ndërtesat, është realizuar 42,299,000 lekë ose 78% kundrejt planit vjetor.
2. Taksa mbi tabelat, është realizuar 3,007,000 leke ose 86% kundrejt planit vjetor.
3. Taksa mbi truallin, është realizuar 6,532,000 leke ose 82% kundrejt planit vjetor.
4. Taksa mbi token bujqësore, është realizuar 15,120,000 lekë ose 81% kundrejt planit vjetor.
5. Të ardhura nga zënia e hapësirave publike (tregu industrial, dhe hapësira të tjera), është realizuar 8,425,000 lekë ose 46% kundrejt planit vjetor.
6. Taksë fjetje në hotel, është realizuar 750,000 ose 16% kundrejt planit vjetor.
7. Taksë ndikimi në infrastrukturë nga ndërtimet e reja, është realizuar 18,256,000 ose 64% kundejt planit vjetor.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Të ardhurat nga tarifat vendore

Kryesisht këto tarifa mblihen nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave, nga Njësitë administrative dhe agjenti tatimor sh.a Ujësjetllës Kanalizime Berat – Kucovë.

Realizimi i këtyre zërave, për vitin 2020 ishte në masën 65% kundrejt planit fillestar.

Nr.	Emertimi	Plani Fillestar 2020	Plani Ndryshuar 2020	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne % Kundrejt Planit Fillestar	Realizimi ne % Kundrejt Planit te Ndryshuar
IV	Tarifat vendore	235,485	153,574	153,818	65%	100%
1	Tarife e pastrimit	100,671	69,463	73,949	73%	106%
2	Tarife e ndriçimit publik	46,311	31,954	31,121	67%	97%
3	Tarife gjelberimi publik	39,786	27,452	25,584	64%	93%
4	Tarife Arsimit publik	11,441	6,292	6,743	59%	107%
5	Tarife e shërbimit administrativ	504	50	40	8%	80%
6	Tarife therje	1,500	600	424	28%	71%
7	Te tjera tarifa(Ambjenti)	455	364	576	127%	158%
8	Tarifa te Drejtorise te Transportit	5,904	5,904	5,949	101%	101%
•	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	5,904	5,904	5,949	101%	101%
9	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	179	-	-	0%	0%
•	Tarfia per zenie salle dhe dheniie ambjentesh me qera	179	-	-	0%	0%
10	Tarifa te Drejtorise te Planifikim Territorit	28,735	11,494	9,432	33%	82%
•	Tarife urbanistike	28,735	11,494	9,432	33%	82%

Zërat më me peshë në këtë grup të ardhurash janë tarifat vendore të pastrimit, ndriçimit, gjelbërimit që mblihen nga biznesi dhe nga familjet.

- 1.Tarifë Pastrimi, është realizuar 73,949,000 lekë ose 73% kundrejt planit vjetor
- 2.Tarifë Ndricimi është realizuar 31,121,000 lekë ose 67% kundrejt planit vjetor
- 3.Tarifë Gjelbërimi është realizuar 25,584,000 lekë ose 64% kundrejt planit vjetor
- 4.Të ardhura nga Drejtoria Ekonomike e Arsimit 11,194,000 lekë ose 56% kundrejt planit vjetor.

Të ardhurat nga tarifat vendore paraqesin nivel të mirë realizimi, por prapë puna vazhdon për të arritur tregues edhe më të mirë realizimi.

Përveç realizimit në nivel të mirë të tarifave mbi biznesin, efekt në realizimin e të ardhurave nga tarifat vendore ka edhe realizimi i të ardhurave nga tarifat e familjes dhe kjo si rezultat i faturimit të këtyre tarifave së bashku me faturën e ujit të pijshëm.

Realizim shumë të mirë kanë edhe të ardhurat nga tarifat e institucioneve shtetërore.(Gjithsej 43 institucione).

Në mënyrë analitike pasqyra e mëposhtme për të gjithë zërat e të ardhurave:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

PASQYRA E REALIZIMIT TË PLANIT TË TË ARDHURAVE PËR VITIN 2020, në 000 lekë

Nr.	Emertimi	Plani Fillestar 2020	Fakti 12 Mujor	Realizimi ne % Kundrejt Planit Fillestar
I	Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin per biznesin e vogel	5,800	7,051	122 %
II	Te ardhura nga tatimi mbi te ardhurat personale	4,619	13,043	282 %
III	Taksat vendore	165,754	128,668	78 %
1	Takse tabelë	3,484	3,007	86%
•	Tabelë për qëllime identifikimi	2,166	2,141	99%
•	Tabelë për qëllime reklamimi	1,318	866	66%
2	Te ardhura nga zënia e hapsirave publike	18,252	8,425	46%
3	Takse e Drejtorise te Planifikim Territorit	28,735	18,256	64%
•	Takse ndikimi ne infrastrukture nga ndertimet e reja	28,735	18,256	64%
4	Takse fjetje ne hotel	4,595	750	16%
5	Takse mbi token bujqesore	18,595	15,120	81%
6	Takse e mjeteve te perdorura	27,391	30,019	110%
7	Takse e kalimit te drejtes se pronsise(ZRPP)	2,521	4,260	169%
8	Takse mbi ndertesat	54,191	42,299	78%
9	Takse trualli	7,976	6,532	82%
10	Te tjera taksa	16	-	0%
IV	Tarifat vendore	235,485	153,818	65 %
1	Tarife e pastrimit	100,671	73,949	73%
2	Tarife e ndricimit publik	46,311	31,121	67%
3	Tarife gjelberimi publik	39,786	25,584	64%
4	Tarife Arsimit publik	11,441	6,743	59%
5	Tarife e sherbimit administrativ	504	40	8%
6	Tarife therje	1,500	424	28%
7	Te tjera tarifa(Ambjenti)	455	576	127%
8	Tarifa te Drejtorise te Transportit	5,904	5,949	101%
•	Tarife per license /certifikate per transport rrugor	5,904	5,949	101%
9	Tarifa te Pallatit te Kultures dhe Bibliotekes	179	-	0%
•	Tarfia per zenie salle dhe dhenie ambjentesh me qera	179	-	0%
10	Tarifa te Drejtorise te Planifikim Territorit	28,735	9,432	33%
•	Tarife urbanistike	28,735	9,432	33%
V	Tarifa te Drejtorise Bujqesise,Administrimit te Pyjeve, Ujerrave dhe Sherbimit Veterinar	4,600	2,006	44 %
1	Tarife per lende drusore	2,900	156	5%
2	Tarife ujitje	1,700	1,850	109%
VI	Tarifa te Drejtorise Ekonomike te Arsimit	19,946	11,194	56 %
1	Te ardhura nga konviktet	1,376	394	29%
2	Te ardhura nga cerdhet	6,555	3,002	46%
3	Te ardhura nga kopshtet	12,016	7,798	65%
VII	Te ardhura te tjera	92,005	17,602	19 %
1	Te ardhura nga Drejtoria e Manaxhimi te Pronave	45,803	10,224	22%
•	Te ardhura nga qerate	19,103	10,128	53%
•	Te tjera te ardhura nga pronesia	26,700	96	0%
2	Te ardhura nga parkimi	3,764	2,889	77%
3	Te ardhura nga gjobat e pa arketuara, k. vonesa etj..	14,493	2,872	20%
4	Te tjera debitore dhe gjyqe	23,000	1,617	7%
5	Tarife e perkohshme (Aktive stok)	4,594	-	0%
VIII	Te ardhura nga MZSH	350	206	59 %
TOTALI		528,209	333,588	63 %

Realizimi i të ardhurave sipas Njërive Administrative:

E rëndësishme të theksojmë se për vitin 2020 biznesi dhe të ardhurat e tij, qoftë nga administrimi i dosjes së silit biznes apo dhe të ardhurat nga arketimet e detyrimeve të tij, administrohen dhe monitorohen nga bashkia dhe jo njësitë administrative.

Ky riorganizim, ka sjellë risit të veçanta në vitin 2020 në mënyrën kontrollin dhe monitorimin e të ardhurave pasi:

Ka raportim ditor dhe periodik nga njësitë për familjet dhe debitorët, si dhe faktin që dhe biznesi i ndodhur gjeografikisht në njesite administrative trajtohet njësoj si dhe biznesi në zonën urbane për nga menyra e administrimit dhe monitorimit të të ardhurave.

Analiza e të dhënave të plota normalisht na jep panoramen e plotë të arketimeve dhe debisë që biznesi ka ndaj bashkisë. E për rrjedhojë dhe forca kontrolluese, kontakti nga inspektorët e borxhit kanë sjellë ndryshim krahasimisht me vitin 2019 por situata pandemike dha ndikimet e veta në këtë aspekt.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

3. REALIZIMI I PLANIT TË SHPENZIMEVE PËR VITIN 2020

3.1 REALIZIMI I PLANIT TË SHPENZIMEVE SIPAS KLASIFIKIMIT BUXHETOR PËR VITIN 2020

1. Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2020 , fillestar, u miratua në shumën 1,075,270 lekë .

Krahasuar me buxhetin fillestar të vitit 2019 është planifikuar me rritje prej 39,219,000 Lekë osë + 4%.

- a. **Shpenzimet korrente** (personeli, shpenzime operative të mirëmbajtjes, të tjera transfertë) , në shumën 901,816,000 lekë , zënë 84% të buxhetit total. Krahasuar me vitin 2019 janë planifikuar me rritje 134,865,000 lekë ose + 18%.
- b. **Shpenzimet kapitale** në shumën 173,454,000 lekë, zënë 16% të buxhetit. Krahasuar me vitin 2019 janë planifikuar me rënie – 95,646,000 lekë ose – 36%.

Tabela e planit të buxhetit fillestar vitet 2019 & 2020

në 000 lekë

Përshkrimi	Buxheti fillestar Plan 2019	% në strukturë	Buxheti fillestar Plan 2020	% në strukturë	Krahasimi buxhet 2020-2019	
					në 000 lek	në %
Totali i Shpenzimeve	1,036,051	100%	1,075,270	100%	39,219	4%
a.Total shpenzime operative (korrente)	766,951	74%	901,816	84%	134,865	18%
1. Shpenzime personeli	499,150	48%	514,286	48%	15,136	3%
2. Shp.operative, & mirëmbajtje & të tjera transf.	267,801	26%	387,530	36%	119,729	45%
b.Shpenzime kapitale	269,100	26%	173,454	16%	-95,646	-36%

2. Buxheti i Bashkisë Berat i vitit 2020 i rishikuar është 1,134,803,403 Lekë

Me VKB nr. 14 datë 27.02.2020 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Berat me shkresën nr 189/1 prot. datë 03.03.2020, u miratua shtesa e buxhetit të bashkisë me 58,316,662 Lekë, për të ardhurat e trashëguara nga viti 2019 në vitin 2020..

Me VKB nr. 58 datë 30.09.2020 konfirmuar u miratua shtesa në buxhetin e bashkisë me 1,216,741 Lekë, për vlerën e garancisë së punimeve të objektit Rikonstruksion i shkollës “Thimi Tane” .

Pas shtesave të bëra në buxhetin e vitit 2020, struktura e shpenzimeve është :

- a. **Shpenzimet korrente** (personeli, shpenzime operative të mirëmbajtjes, të tjera transfertë) , në shumën 960,132,000 lekë , zënë 85 % të buxhetit total.
- b. **Shpenzimet kapitale** në shumën 174,671,000 lekë, zënë 15% të buxhetit.

Tabela e planit të buxhetit të rishikuar vitet 2019 & 2020

në 000 lekë

Përshkrimi	Buxheti i rishikuar Plan 2019	% në strukturë	Buxheti i rishikuar Plan 2020	% në strukturë	Krahasimi buxhet 2020-2019	
					në 000 lek	në %
Totali i Shpenzimeve	1,168,760	100%	1,134,803	100%	-33,957	-3%
a.Total shpenzime operative (korrente)	796,299	68%	960,132	85%	163,833	21%
1. Shpenzime personeli	508,176	43%	513,936	45%	5,760	1%
2. Shp.operative, & mirëmbajtje & të tjera transf.	288,123	25%	446,196	39%	158,073	55%
b.Shpenzime kapitale	372,461	32%	174,671	15%	-197,790	-53%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

3. Realizimi i Buxhetit të shpenzimeve të Bashkisë Berat për vitin 2020 është 816,588,000 Lekë , kundrejt shpenzimeve të planifikuara në vlerën 1,134,803,000 Lekë, ose në masën 72%. Diferenca e parealizuar është 318,214,000 Lekë.

a. Shpenzimet korrente (personeli, shpenzime operative të mirëmbajtjes, të tjera transfera) , u realizuan në vlerën 727,301,000 Lekë kundrejt të planifikuarave në shumën 960,132,000 lekë , ose në masën 75.8%. Diferenca e parealizuar në vlerë është 232,831,000 Lekë.


b. Shpenzimet kapitale u realizuan në vlerën 89,287,000 Lekë kundrejt planit në shumën 174,671,000, ose në masën 51%. Diferenca e parealizuar në vlerë është 85,383,000 lekë .

Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë

në 000 lekë

Njesia Bashkia Berat + Nd. e vartesisë									
Kodi i in	E konsoliduar								
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Plan Buxheti 8-Mujor	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	411,407	441,314	441,314	440,945	312,958	399,352	41,593	91%
601	Sigurime Shoqërore	68,380	72,972	72,972	72,992	53,044	66,538	6,455	91%
500+601	Paga +Sigurime	479,787	514,286	514,286	513,937	366,002	465,890	48,047	91%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	150,534	344,389	344,389	382,588	290,121	227,310	155,279	59%
603	Subvencione	23,000	25,000	25,000	25,000	19,050	25,000	0	100%
604	Transfera Korente të Brendshme	1,458	3,060	3,060	3,960	3,060	3,945	15	100%
605	Transfera Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Indiv	4,267	15,081	15,081	34,647	30,780	5,156	29,491	15%
602-606	Shpenzime operative	179,259	387,530	387,530	446,195	343,011	261,410	184,785	59%
	Shpenzime Korrente	659,047	901,816	901,816	960,132	709,013	727,300	232,832	76%
230	Kapitale të Patrupëzuara	256	14,381	14,381	14,381	13,481	10,320	4,062	72%
231	Kapitale të Trupëzuara	245,005	159,073	159,073	160,290	117,598	78,968	81,321	49%
Totali	Shpenzime Kapitale	245,261	173,454	173,454	174,671	131,079	89,288	85,383	51%
Totali (korrente + kapitale)		904,308	1,075,270	1,075,270	1,134,803	840,092	816,588	318,215	72%

Grafiku i Realizimit të shpenzimeve viti 2020 (në 000 lekë)





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi i buxhetit sipas artikujve për vitet 2019 dhe 2020 në 000 lekë

Art.	Emertimi	Viti 2019		Viti 2020		Krahasimi buxhet 2020-2019	
		Fakt 2019	Pesha ne strukt. %	Fakt 2020	Pesha ne strukt. %	në 000 lek	në %
600	Paga	411,407	45%	399,352	49%	-12,055	-2.9%
601	Sigurime Shoqërore	68,380	8%	66,538	8%	-1,842	-2.7%
600+601	Paga + Sigurime	479,787	53%	465,890	57%	-13,897	-2.9%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	150,534	17%	227,310	28%	76,775	51.0%
603	Subvencione	23,000	3%	25,000	3%	2,000	8.7%
604	Transferta Korente të Brendshme	1,458	0%	3,945	0%	2,487	170.6%
605	Transferta Korente të Huaja	0	0%	0	0%	0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individe	4,267	0%	5,156	1%	889	20.8%
602-606	Shpenzime operative	179,259	20%	261,410	32%	82,151	45.8%
Shpenzime Korrente		659,047	73%	727,300	89%	68,254	10.4%
230	Kapitale të Patrupëzuara	256	0%	10,320	1%	10,064	3931.1%
231	Kapitale të Trupëzuara	245,005	27%	78,968	10%	-166,037	-67.8%
Shpenzime Kapitale		245,261	27%	89,288	11%	-155,973	-63.6%
Totali (korrente + kapitale)		904,308	100%	816,588	100%	-87,720	-9.7%

Realizimi i planit të shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë :

Artikulli 600 : Paga - është realizuar në masën 91% ; nga shuma e planifikuar prej 440,945,000 lekë janë shpenzuar 399,354,000 Lekë . Numri maksimal i planifikuar i punonjësve të bashkisë për vitin 2020 ishte 724 dhe 691 ishte numri faktik në datën 31.12.2020

Numri i punonjësve të Bashkisë Berat sipas njësive shpenzuese (në datën 31.12.2020)

Nr	Njësia Shpenzuese	Viti 2018	Viti 2019	Viti 2020 Plan	Fakt 2020	Diferenca	% e realizimit
1	Bashkia Berat (Aparati)	185	178	194	176	18	91%
	<i>Administrata e Bashkisë</i>	133	115	136	123	13	90%
	<i>Policia Bashkiake</i>	12	17	16	16	0	100%
	<i>Inspektoriati i Mbrojtjes se Territorit</i>	3	3	4	4	0	100%
	<i>MZSH</i>	37	43	38	33	5	87%
2	Ndërmarrja e Gjellbërimit	58	58	55	54	1	98%
3	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	65	79	76	74	2	97%
4	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	310	313	310	310	0	100%
5	Qendra Kulturore " M. Tutulani "	27	33	29	25	4	86%
6	Drejtoria e Bujqesise	37	39	38	32	6	84%
7	Qendra "Lira"	22	24	22	20	2	91%
	TOTALI	704	724	724	691	33	95%

Artikulli 601 : Sigurime shoqërore - është realizuar në masën 91% ; planifikuar 72,992,000 lekë dhe u realizuan 66,536,000 lekë. Janë paguar rregullisht cdo muaj detyrimet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore, duke mos krijuar detyrime ndaj DRT në asnjë njësi shpenzuese në varësi të Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Totali i shpenzimeve të personelit (art 600+601) : Janë planifikuar në total 513,937,000 lekë dhe janë shpenzuar në fakt 465,890,000 lekë. Ky zë shpenzimi është realizuar në masën 91% të planit.

Realizmi 91% është për arsye të mosplotësimit të strukturës së punonjësve me numrin maksimal të planifikuar, mbi bazën e të cilit është bërë edhe përlogaritja e fondit të pagave.

Shpenzimet faktike për Personelin zënë 41 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (465,890,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i artikullit Shpenzime personeli në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizi mit	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizi mit
	Shpenzime personeli	508,176	43%	479,787	53%	94%	513,937	45%	465,890	41%	91%
600	Paga	435,905	37%	411,407	45%	94%	440,945	39%	399,354	35%	91%
601	Sigurime Shoqërore	72,271	6%	68,380	8%	95%	72,992	6%	66,536	6%	91%
	Buxheti Total	1,168,760	100%	904,308	100%	77%	1,134,803	100%	816,588	72%	72%

Artikulli 602 : Mallra dhe shërbime të tjera - Janë parashikuar në total shpenzime në shumën 382,588,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 277,309,000 lekë, ose realizuar në masën 59.4 %. Diferenca e parealizuar është 155,279,000 lekë, ose 40.6%. Në këtë artikull kemi shpenzime të kryera të dokumentuara me fatura, pra janë kryer shërbimet e nevojshme, por për të cilet nuk kemi patur fonde në dispozicion për të kryer pagesa. Në vijim të materialit jepet informacion më i detajuar sipas programeve dhe sipas njësive shpenzuese .

Shpenzimet faktike për Mallra dhe shërbime të tjera zënë rreth 28 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (277,309,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i artikullit Mallra dhe shpenzime në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizi mit	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizi mit
602	Mallra dhe Shërbime	244,411	21%	150,534	17%	62%	382,588	34%	227,309	28%	59%
	Buxheti Total	1,168,760	100%	904,308	100%	77%	1,134,803	100%	816,588	100%	72%

Artikulli 603 : Subvencione - Shpenzime të planifikuara 25,000,000 lekë dhe të realizuara 25,000,000 lekë, ose në masën 100% . Këto shpenzime përfaqësojnë shumën e subvencionuar për sh.a. “FK Tomori 1923”, ku Bashkia Berat zotëron 100% të aksioneve të shoqërisë.

Shpenzimet faktike për Subvencione zënë 3 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (25,000,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i artikullit Subvencione në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizi mit	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizi mit
603	Subvencione	23,000	2%	23,000	3%	100%	25,000	2%	25,000	3%	100%
	Buxheti Total	1,168,760	100%	904,308	100%	77%	1,134,803	100%	816,588	100%	72%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Artikulli 604 : Transferta korrente të brendshme - Shuma e parashikuar për shpenzime në këtë artikull buxhetor është 3,960,000 lekë dhe është realizuar fakt 3,945,000 lekë, ose realizim në masën 99,6 %.

Në transfertat e Bashkisë Berat përfshihen :

1. Transfertë për Këshillin e Qarkut (kuotë), planifikuar sipas ligjit 68/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 38 pika 3. Realizimi 100%, raporti fakt/plan 650,000/650,000 lekë.
2. Detyrim kontraktual ndaj Ndërmarrjes Ujësjetellës-Kanalizime në rolin e agjentit tatimor për arkëtimin e tarifave vendore nga familjet nëpërmjet faturës mujore të ujit. Realizimi 99,5%, raporti fakt/plan 2,224,000/2,235,000 lekë .
3. Transferimi i tarifave vendore që paguan biznesi i zonës BID (Pedonalja) Realizimi 100%, raporti fakt/plan 1,000,000/1,000,000 lekë
4. Transfertë për Drejtorinë Rajonale të Tatimeve për tatimin e thjeshtuar (1 % mbi shumën e arkëtuar sipas përcaktimit ligjor). Realizimi 94%, raporti fakt/plan 71,000/74,000 lekë.

Shpenzimet faktike për Transferta korrente të brendshme zënë 0,5 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (3,945,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i artikullit Transferta korrente të brendshme

në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizim it	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizimi t
604	Transferta Korente të Brendshme	3,840	0.3%	1,458	0.2%	38.0%	3,960	0.3%	3,945	0.5%	99.6%
	<i>Këshilli i Qarkut</i>	1,000		200		20.0%	650		650		100.0%
	<i>Detyrim kontr. UKBK</i>	1,000		1,020		102.0%	2,235		2,224		99.5%
	<i>Partneritet Shoq.BID</i>	1,340		200		14.9%	1,000		1,000		100.0%
	<i>Transfertë për DRT</i>	500		38		7.6%	75		71		94.0%
Buxheti Total		1,168,760	100%	904,308	100%	77.4%	1,134,803	100%	816,588	100%	72%

Artikulli 606 : Transferta për buxhetet, familjet dhe individët - Janë parashikuar në këtë artikull buxhetor shuma 41,693,000 lekë dhe janë shpenzuar në fakt 12,797,000 lekë, ose realizim i planit në masën 30% .

Në këtë artikull përfshihen : **Fondi rezervë, fondi i kontingjencës, fondi i emergjencave civile dhe i mbrojtjes civile.** Po ashtu edhe transfertat tek familje apo individë për : bonus strehimi/subvencion qeraje, trajtimi me ndihmë ekonomike i rasteve të vecanta nga fondet e bashkisë, dhënie ndihme financiare për individë në raste të vecanta. Në të gjitha rastet përdorimi i fondeve është bërë me miratim të KB.

Fondi Rezervë : Bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore” dhe nenit 6 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, për të përballuar shpenzime të paparashikuara në buxhetin e njëjësive të qeverisjes vendore, krijohet Fondi rezervë. Në buxhetin e viti 2020 është planifikuar fond rezervë në shumën 2,500,000 lekë. Fondi Rezervë nuk është përdorur për vitin 2020.

Fondi i Kontingjencës : Për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara, të programeve ekzistuese krijohet Fondi i Kontingjencës. Të dy këto fonde miratohen në masën deri në 3 (tre) % të vlerës së përgjithshme të fondeve të miratuara, duke përjashtuar transfertat e kushtëzuara . Fondi i Kontingjencës nuk është përdorur për vitin 2020.

Fondet e Emergjencës dhe për Mbrojtjen Civile : Në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” , fondi i emergjencave civile planifikohet në shumë totale minimalisht 4 % të totalit të buxhetit të Bashkisë, të cilat sigurohen nga fondet e kushtëzuara të buxhetit të shtetit. Për vitin 2020, nga Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

buxheti qendror nuk u akorduan fonde specifike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, si dhe kryerjen e detyrave në zbatim të ligjit nr 45/2019. Në buxhetin e bashkisë u parashikuan nga të ardhurat e veta fonde në shumën 20,780,000 lekë dhe u përdorën 8,327,000 lekë, ose në masën 40% , për qëllimet e mëposhtme :

- ✓ 804,400 lekë për ndihmë familjeve të dëmtuara nga tërmeti
- ✓ 7,641,850 lekë në funksion të zbatimit të deyrimeve ligjore të dala për përballimin e situatës së pandemisë covid-19. Ekipi i posacëm dhe Shërbimi social u angazhuan maksimalisht në identifikimin e personave dhe familjeve në nevojë emergjente për ndihma ushqimore. Po ashtu u morën masa për dezinfektimin e hapësirave publike, tregjeve, institucioneve. Fondi 7,641,850 lekë u përdor për :
 - 7,088,410 lekë për blerje artikuj ushqimorë . Sipas listave të individëve dhe familjeve në nevojë, grupi i punës përgatiti pakot ushqimore dhe i shpërndau nëpër banesa në të gjithë territorin e bashkisë, sipas grafikut të përcaktuar, në kushtet e masave mbrojtëse ndaj covid-19. U asistuan me ndihma pako ushqimorë familjet në nevojë, pensionistët, grupet e marxhinalizuara, konkretisht : 382 pako për pensionistët, 419 pako për familjet në nevojë, 1324 pako për familjet e klasifikuara sipas VKM, 2402 pako për familje të tjera në vështirësi ekonomike.
 - 424,439 lekë për dizinfektantë
 - 118,800 lekë për pompa për dizinfektim
 - 10,200 lekë për termometra për institucionet arsimore

Bonus strehimi/Subvencion qeraje : Realizimi 36 %, fakt 1,508,000 lekë / 4,200,000 lekë

Shërbime sociale : Realizimi 74 %, fakt 1,601,000 lekë / plan 2,159,000 lekë. Nga të cilat 1,469,000 për trajtim me ndihmë ekonomike rastet e vecanta, dhe 132,000 lekë dhënie ndihmë financiare për individë në kushte të vështira.

Fondi i vecantë : Në këtë artikull është përdorur fondi i vecantë në shumën 1,243,000 lekë, për shpërblim dalje në pension dhe raste fatkeqësie , sipas kriterëve ligjore dhe urdhër të titullarit.

Shpenzimet faktike për këtë artikull zënë 1.6 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (12,797,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i artikullit Transferta për buxhetet, familjet dhe individët në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizim it	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizi mit
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	16,220	1.4%	4,267	0.5%	26%	43,265	3.8%	12,797	1.6%	30%
	Fond rezervë	2,500		150		6%	2,500		0		0%
	Fond kontingjence	6,000		0		0%	12,055		0		0%
	Fond emergjence	2,500		398		16%	2,500		804		32%
	Mbrojtja civile (fakti ne art.602)	0		0			18,280		7,642		42%
	Bonus Strehimi/ Subvencion Qeraje	1200		1,226		102%	4,200		1,508		36%
	Sherbime sociale	3020		1,558		52%	2,159		1,601		74%
	Fondi i vecante	1,000		936		94%	1,572		1,243		79%
Buxheti Total		1,168,760	100%	904,308	100%	77%	1,134,803	100%	816,588	100%	72%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Artikulli 230&231 : Shpenzime kapitale të patrupëzuara dhe të trupëzuara – Fondet e planifikuara në këtë artikull buxhetor janë në shumën 174,671,000 lekë dhe zënë 15% të plan buxhetit total 2020. Shpenzimet faktike janë realizuar në shumën 89,287,000 lekë, ose në masën 51% të planit. Shpenzimet faktike për Shpenzime kapitale zënë 11 % të totalit të shpenzimeve faktike vjetore (89,287,000 / 816,588,000 lekë).

Realizimi i buxhetit të investimeve

në 000 lekë

Art.	Emërtimi	viti 2019					viti 2020				
		Plan 2019	% në strukt urë	Fakt 2019	% në strukt urë	% e realizi mit	Plan 2020	% në strukt urë	Fakt 2020	% në strukt urë	% e realizi mit
230+231	Shpenzime Kapitale	372,461	32%	245,261	27%	66%	174,671	15%	89,287	11%	51%
	Buxheti Total	1,168,760	100%	904,308	100%	77%	1,134,803	100%	816,588	100%	72%

*Realizimi i planit në këtë artikull, sipas programeve buxhetore dhe sipas objekteve jepet në aneksin nr. 5 bashkëlidhur.

Informacion i detajuar mbi realizimin e investimeve :

Tabela e realizimit të investimeve sipas programeve buxhetore

në 000 lekë

Emërtimi i projektit	Planifikuar per vitin 2020	% në strukturë	Likujduar per periudhen 12-mujore	% në strukturë	Realizimi ne %
1. Programi 01110 / Planifikim, Menaxhim, Administrim	6,728	3.9%	186	0.2%	3%
Pajisje Aparati (Programe kompjuterike, softëare)	1,500	0.9%	186	0.2%	12%
Sistemi i kondicionimit godina e bashkise	5,228	3.0%	0	0.0%	0%
2. Programi 01710 / Sherbime te huamarrjes vendore	8,413	4.8%	7,321	8.2%	87%
Kredia e banesave sociale	8,413	4.8%	7,321	8.2%	87%
3. Programi 03280 / Sherbimi zjarrfikes	1,696	1.0%	1,696	1.9%	100%
Kosto lokale, TVSH per blerje automjet zjarrfikese	1,696	1.0%	1,696	1.9%	100%
4. Programi 04240 / Ujitja dhe Kullimi	7,570	4.3%	4,870	5.5%	64%
Mirembajtje Ujesjellesa e KUZ (Kostren)	2,500	1.4%	0	0.0%	0%
Pajisje Drejtoria e bujqesise	70	0.0%	70	0.1%	100%
Bujqesia Mjet Transporti	5,000	2.9%	4,800	5.4%	96%
5. Programi 04520/230 Rrjeti rrugor (Hartim Projektesh)	14,381	8.2%	10,320	11.6%	72%
Kerkime, studime, hartim projektesh	14,381	8.2%	10,320	11.6%	72%
6. Programi 04520 / 231 Rrjeti rrugor	78,254	44.8%	27,767	31.1%	35%
Supervizime e Kolaudime	1,934	1.1%	143	0.2%	7%
Shpronesim per interes publik	27,060	15.5%	1,819	2.0%	7%
Blerje pajisje per ndricim	960	0.5%	900	1.0%	94%
Rik. i rruges Stadium i Vjeter Stadium i Ri (bashkefinancim i Bashkise dhe Kontrata Shtese)	485	0.3%	0	0.0%	0%
Blerje Fadrome per Ndermarrjen e Sherbimeve Publike	653	0.4%	653	0.7%	100%
Fasadat ne lagjen M. Celebiu	13,000	7.4%	0	0.0%	0%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Rokonstr rrugesh, trotuar dhe ndricim 30 vjetori ish pjeshkorja	17,910	10.3%	17,000	19.0%	95%
Asfaltim dhe shtrim rrugesh me beton, mirembajtje me cakull dhe tombino e mure mbajtes ne njesite administrative dhe lagjet e qytetit	9,000	5.2%	0	0.0%	0%
Ndricim rrugesh ne fshatin Dushnik	7,000	4.0%	7,000	7.8%	100%
Pajisje Ndermarrja e Sherbimeve	252	0.1%	252	0.3%	100%
7. Programi 05100 / Menaxhimi i mbetjeve	12,444	7.1%	6,999	7.8%	56%
Blerje konteneresh	9,000	5.2%	3,600	4.0%	40%
Rehabilitim i Rruges inerte Projekti "Menaxh. I mb. te ngurta	3,444	2.0%	3,399	3.8%	99%
8. Programi 06260 Sherbime Publike	3,365	1.9%	240	0.3%	7%
Ndermarrja e Gjelberimit (Hapesira te gjelberta, lulishte)	3,365	1.9%	240	0.3%	7%
9. Programi 6330 / Ujesjelles Kanalizime	6,000	3.4%	0	0.0%	0%
Ndertim Ujesjellesi fshati Qereshnik	6,000	3.4%	0	0.0%	0%
10. Programi 7220 / Kujdesi paresor	1,512	0.9%	0	0.0%	0%
Rikonstrukcioni i Pediatrie se Spitalit Rajonal Berat	1,512	0.9%	0	0.0%	0%
11. Programi 08130 Sportet	2,164	1.2%	0	0.0%	0%
Rionstrukcion i palestres se gjimnastikes	2,164	1.2%	0	0.0%	0%
12. Programi 8220 / Kultura	691	0.4%	0	0.0%	0%
Ndertim i Muzeut Sinje+ mobilim	191	0.1%	0	0.0%	0%
Kultura (Libra, fondi i bibliotekes)	500	0.3%	0	0.0%	0%
13. Programi 09120 Arsimi	31,453	18.0%	29,890	33.5%	95%
Rikonstrukcion Shkolla "1 Maji"	27,236	15.6%	27,000	30.2%	99%
Arsimi (Krevate per kopshtet, tavolina, karrige, soba)	3,000	1.7%	2,890	3.2%	96%
Investime ne shkollen "Thimi Tane"	1,217	0.7%	0	0.0%	0%
Totali i investimeve me fonde te bashkise	174,671	100%	89,287	100%	51%

1. Programi 01110 : Planifikim Menaxhim Administrim
realizimi 3%, fakt 186,000 lekë / plan 6,728,000 lekë

Ky program përmban 2 projekte :

1.1 “Pajisje Aparati i Bashkisë, programe kompjuterike, softëare” - vlera e parashikuar e projektit është 1,500,000 lekë, nga të cilat u realizuan blerje pajisje me vlerë 186,000 lekë.

Viti i fillimit të projektit është 2020 dhe viti i përfundimit 2020. Diferenca e vlerës së parashikuar nuk u prokurua për arsye të mungesës së fondeve.

1.2 “Sistemi i Kondicionimit godina e bashkisë” vlera e plotë e projektit 21,558,000 lekë dhe vlera e kontratës

21,558,000 lekë. Viti i fillimit 2018 dhe viti i përfundimit 2019. Projekti është përfunduar dhe është në periudhën e garancisë, e cila mbaron në vitin 2021.

Në buxhetin e vitit 2020 u parashikua shuma 5,228,000 lekë , e cila do të likujdonte plotësisht vlerën e projektit/kontratës. Për mungesë fondesh nuk u realizua ky shpenzim/likujdim. Është programuar të likujdohet në buxhetin e vitit 2021 shuma 2,228 mijë lekë, dhe në vitin 2022 shuma 3,000 mijë lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2. Programi 01710 : Shërbime të huamarrjes vendore
realizimi 87%, fakt 7,321,000 lekë / plan 8,413,000 lekë

Ky program përmban projektin “Kredia e banesave sociale” me vlerë të kështit të kredisë për vitin 2020 në shumën 58,770.70 ose 8,413,000 lekë.

Viti i fillimit dhe përfundimit të projektit (kësti vjetor i kredisë) është 2020. Shlyerja është bërë sipas transeve të kredisë të dërguara nga MFE. Kësti i kredisë është likjuar plotësisht; diferenca përfaqëson ndryshimin në kursin e këmbimit në datat e shlyerjes së kësteve dhe datës së planifikimit.

Në bazë të marrëveshjes së nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat, në të cilën janë përcaktuar kështet vjetore të shlyerjes, kemi:

- Vlera totale e kredisë së disbursuar është 587,707 eur
- Afati i shlyerjes së kredisë : 12/2014 – 07/2026
- Vlera e mbetur e pashlyer e kredisë në datën 31.12.2020 është 232,053 eur.

3. Programi 3280 : Shërbimi zjarrfikës
Realizimi 100% , fakt 1,696,00 lekë / plan 1,696,000 lekë

Në këtë program përfshihet projekti “Kosto lokale, TVSH për blerje automjet zjarrfikës”. Ky projekt është realizuar plotësisht në vitin 2020. (Blerja e mjetit është realizuar me fonde të sponsorizuara nga Ambasada Japoneze në Shqipëri. Shuma e sponsorizimit : 9,248,000 lekë).

4. Programi 4240 : Ujitja dhe Kullimi
Realizimi 64%, fakt 4,870,000 lekë / plan 7,570,000 lekë

Në këtë program përfshihen 3 projekte :

4.1 Projekti “Mirëmbajtje Ujësjiellësa e KUZ Kostren” , programuar për vitin 2020 në vlerë 2,500,000 lekë. Viti i fillimit dhe përfundimit 2018. Vlera e kontratës 4,962,000 lekë. Në vitin 2020, për mungesë fondesh nga mosrealizimi i të ardhurave, nuk u krye likujdimi i parashikuar. Është programuar të likujdohet vlera e plotë 4,962,000 lekë në buxhetin e vitit 2021.

4.2 Projekti “ Blerje Pajisje Drejtoria e Bujqësisë” , me vlerë të programuar 70,000 lekë. Viti i fillimit dhe i mbarimit është 2020 . Vlera e kontratës dhe vlera e realizuar 70,000 lekë.

4.3 Projekti “Blerje Mjet transporti Drejtoria e Bujqësisë” me vlerë të programuar 5,000,000 lekë. Viti i fillimit dhe i mbarimit është 2020 . Vlera e kontratës dhe vlera e realizuar 4,800,00 lekë.

5. Programi 4520/230 : Hartim Projektesh
Realizimi 72% , fakt 10,320,000 lekë / plan 14,381,000 lekë

Ky program përmban projektin ”Hartim Projektesh, Kërkime, Studime” me vlerë të planifikuar 14,381,000 lekë. Viti i fillimit dhe i mbarimit është 2020. Vlerë kontrata 10,320,000 lekë dhe vlerë e realizuar 10,320,000 lekë.

6. Programi 4520/231 : Rrjeti Rrugor
Realizimi 35%, fakt 27,767,000 lekë / plan 78,254,000 lekë

Ky program përmban 10 projekte, si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

6.1 “Supervizime e Kolaudime” projekt i planifikuar në buxhet me vlerë 1,934,000 lekë, nga të cilat janë realizuar 143,000 lekë. Diferenca nuk është likuajduar për mungesë fondesh; është parashikuar për pagesë në vitin 2021.

6.2 “Shpronësim për interes publik “ me vlerë të planifikuar projekti 27,060,000 lekë. Janë realizuar shpenzime në shumën 1,819,000 lekë për shpronësimet e kryera në objektet “Zgjerim i varrezave në fshatin

Roshnik” dhe “ Sistemim i hapësirës në lagjen “D. Kastrioti””. Nuk u realizuan pagesat për shpronësimet e objekteve të tjera për arsye të mos plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm nga ana e përfituesve. Në buxhetin e vitit 2021 është planifikuar likuidimi i tyre.

6.3 “Blerje pajisje për ndricim” me vlerë të planifikuar në buxhet 960,000 lekë. Vlera e kontratës është 900,000 lekë dhe është likuajduar në masën 100%.

6.4 “Rikonstruksioni i rrugës Stadium i Vjetër Stadium i Ri (bashkëfinancim i Bashkisë dhe Kontrata Shtesë)” Në buxhetin e vitit 2020 u planifikuan për këtë projekt fonde në shumën 485,000 lekë . Shpenzimet e planifikuara nuk u realizuan për mungesë fondesh. Vlera e kontratës dhe e projektit është 59,051,000 lekë. Likuidimi progresiv i kontratës është 58,197,000 lekë, diferenca nga kontrata 854,000 lekë.

6.5 “Blerje Fadrome për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike” me vlerë projekti dhe vlerë kontrate 9,850,000 lekë. Viti i fillimit dhe i përfundimit 2018. Parashikimi i shpenzimeve në buxhetin e vitit 2020 është 653,000 lekë dhe realizimi 653,000 lekë. Likuidimi progresiv i kontratës është 9,653,999 lekë.

6.6 “Fasadat në lagjen Murat Çelebiu” me vlerë projekti dhe kontrate 44,430,000 lekë. Viti i fillimit 2018 dhe viti i përfundimit 2019. Në buxhetin e vitit 2020 për këtë projekt janë planifikuar shpenzime në vlerën 13,000,000 lekë , të cilat nuk janë realizuar për mungesë fondesh. Likuidimi progresiv i kontratës është 28,300,000 lekë. Diferenca e mbetur 16,130,000 lekë është parashikuar të likujdohet në vitet 2021 dhe 2022, respektivisht shumat 13,000,000 lekë dhe 2,130,000 lekë.

6.7 “Rikonstruksion rrugësh, trotuare dhe ndriçim 30 Vjetori, ish pjeshkorja” me vlerë totale projekti 76,904,000 lekë dhe me po këtë vlerë kontrate. Viti i fillimit 2017 dhe viti i përfundimit 2020. Në buxhetin e vitit 2020 për këtë projekt janë planifikuar shpenzime në vlerën 17,910,000 lekë dhe janë realizuar në shumën 17,000,000 lekë . Likuidimi progresiv është 58,084,000 lekë.

6.8 “Asfaltim dhe shtrim rrugësh me beton, mirëmbajtje me çakull dhe tombino e mure mbajtës në njësitë administrative dhe lagjet e qytetit”, projekt me vlerë totale 60,669,000 lekë. Viti i fillimit 2018 dhe viti i përfundimit 2021. Në buxhetin e vitit 2020 për këtë projekt janë parashikuar 9,000,000 lekë, të cilat nuk u realizuan për mungesë fondesh. Likuidimi progresiv është 36,706,000 lekë. Diferenca e mbetur e palikuajduar nga kontrata është parashikuar të likujdohet në vitet 2021-2022.

6.9 “Ndriçim rrugësh në fshatin Dushnik”, projekt me vlerë kontrate 8,157,000 lekë. Viti i fillimit 2019 dhe i përfundimit 2020. Në buxhetin e vitit 2020 për këtë projekt janë parashikuar 9,000,000 lekë, të cilat janë realizuar 100% .

6.10 “Blerje pajisje (Ndërmarrja e Shërbimeve Publike)”, projekt me vlerë të buxhetuar 252,000 lekë. Viti i fillimit dhe i mbarimit 2019. Procedura u krye në vitin 2019 , por për mungesë fondesh u parashikua likuidimi në buxhetin e vitit 2020 . Vlera e kontratës 252,000 lekë është likuajduar 100% në vitin 2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

7. Programi 5100 : Menaxhimi i Mbetjeve

Realizimi 56%, fakt 6,999,000 lekë / plan 12,444,000 lekë

Ky program ka në përmbajtje të tij 2 projekte :

7.1“Blerje Kontenierësh” projekt me vlerë 17,208,000 lekë. Viti i fillimit 2019 dhe viti i përfundimit 2021. Në buxhetin e vitit 2020 shuma e parashikuar për këtë projekt është 9,000,000 lekë . Janë kryer likujdime në shumën 3,600,000 lekë për vlerën e 100 kontenierëve të blerë. Diferenca 5,400,000 lekë nuk është likjuar për mungesë fondesh.

7.2“Rehabilitim i rruges inerte projekti Menaxhim i mbetjeve të ngurta”, projekt me vlerë totale të kontraktuar 21,486,000. Viti i fillimit të projektit 2020 dhe viti i mbarimit 2021. Në buxhetin e vitit 2020 shuma e parashikuar për këtë projekt është 3,444,000 lekë, e cila është realizuar/likjuar 3,399,000 lekë (vlera e situacionit të punimeve të kryera).

8. Programi 06260 : Shërbime Publike

Realizimi 7%, fakt 240,000 / plan 3,365,000 lekë

Ky program përmban 1 projekt :

8.1“ Shtim e përmirësim hapësira të gjelbra,lulishte, Ndërmarrja e Gjellbërimit ” me vlerë 3,365,000 lekë. Viti i fillimit dhe përfundimit të projektit është viti 2020. Është realizuar vetëm shtimi i një pusi uji për vaditje me vlerë të kontraktuar dhe likjuar për 240,000 lekë. Pjesa tjetër nuk është prokuruar, për mungesë fondesh.

9. Programi 06330 : Ujësjiellës Kanalizime

Realizimi 0% , fakt 0 lekë / plan 6,000,000 lekë

Ky program përmban 1 projekt :

9.1“Ndërtim Ujësjiellësi fshati Qereshnik” projekt me vlerë 36,991,000 lekë. Viti i fillimit 2017 dhe i përfundimit 2018. Vlera e Kontratës 36,991,000 lekë. Parashikuar për t’u paguar në vitin 2020 shuma 6,000,000 lekë. Likjuar 0 lekë për mungesë fondesh. Likujdimi progresiv i kontratës është 29,607,000 lekë . Mbetja nga kontrata është parashikuar të likjohet në vitin 2021.

10. Programi 7220 : Kujdesi Parësor

Realizimi 0% , fakt 0 lekë / plan 1,512,000 lekë

Ky program përmban 1 projekt :

10.1“Rikonstruksioni i Pediatriisë së Spitalit Rajonal Berat” projekt me vlerë kontrate 11,567,000 lekë. Projekti filloi dhe përfundoi në vitin 2018. Parashikuar për t’u likjuar në vitin 2020 shuma 1,512,000 lekë, por nuk u krye për mungesë fondesh. Likujdimi progresiv i vlerës së kontratës është 10,055,000 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

11. Programi 8130 : Sportet

Realizimi 0% , fakt 0 lekë / plan 2,164,000 lekë

Ky program përmban 1 projekt :

11.1 “Rikonstrukcion i palestrës së gjimnastikës” me vlerë projekti dhe kontrate 5,898,000 lekë. Projekti ka filluar dhe ka mbaruar ne vitin 2018. Janë parashikuar për të likujduar 2,164,000 lekë në vitin 2020, por realizimi është 0% për mungesë fondesh. Likujdimi progresiv i kontratës është 3,734,000 lekë.

12. Programi 8220 : Kultura

Realizimi 0%, fakt 0 lekë / plan 691,000 lekë

Ky program përmban 2 projekte :

12.1 “Ndërtim i Muzeut Sinjë dhe mobilim” me vlerë projekti dhe vlerë kontrate 9,161,000 lekë. Viti i fillimit dhe i përfundimit të projektit është viti 2018. Në buxhetin e vitit 2020 janë parashikuar të likujdohen 191,000 lekë për këtë projekt, por për mungesë fondesh likujdimi nuk u krye. Likujdimi progresiv i projektit është 7,830,000 lekë.

12.2 “Blerje Libra për shtimin e fondit të bibliotekës në Qendrën Kulturore” projekt me vlerë të buxhetuar 500,000 lekë. Nuk u zhvillua procedura e prokurimit për arsye të mungesës së fondeve.

13. Programi 9120 Arsimit

Realizimi 95%, fakt 29,890,000 lekë / plan 31,453,000 lekë

Ky program përmban 3 projekte investimesh :

13.1 “Rikonstrukcion shkolla “1 Maji” + Supervizim + Kolaudim, me vlerë projekti dhe vlerë kontrate 58,150,000 lekë. Ky projekt ka filluar në vitin 2018 dhe përfundon në vitin 2021. Parashikimi për likujdim i vitit 2020 është 27,236,000 lekë, nga të cilat janë likujduar 27,000,000 lekë. Objekti ka përfunduar dhe është marrë në dorëzim. Likujdimi progresiv i projektit është 47,914,000 lekë. Mbetja e palikujduar nga kontrata është 10,236,000 lekë.

13.2 “Pajisje e kopshteve me krevate,tavolina,karrige,soba, Drejtoria Arsimore Bashkia Berat” , projekt me vlerë të parashikuar në buxhet 3,000,000 lekë. Viti i fillimit dhe i mbarimit është viti 2020. Vlera e kontratës është 2,890,000 lekë, e cila është likujduar plotësisht.

13.3 “Punime riparimi në shkollën Thimi Tane”, projekt me vlerë 1,217,000 lekë. Projekti fillon dhe përfundon në vitin 2020. Investimi ka përfunduar,por likujdimi nuk është kryer për arsye të plotësimit të dokumentacionit nga ana e subjektit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

a. REALIZIMI I PLANIT TË SHPENZIMEVE SIPAS PROGRAMEVE BUXHETORE DHE NJËSIVE SHPENZUESE

Buxheti i bashkisë Berat është planifikuar dhe realizuar në 7 njësi shpenzuese sipas programeve buxhetore që ato menaxhojnë. Përshtatja e gjithë informacionit financiar është mbi bazën e strukturës së 9 fushave/funksioneve kryesore që janë përgjegjësi ligjore e njësisë së qeverisjes vendore sipas ligjit 139/2015, dhe 27 nënfunksioneve, sipas kodifikimit COFOG, i cili unifikon njëkohësisht dhe marrëdhënien me Qeverinë Qendrore /Degën e Thesarit.

Në pasqyrën e mëposhtme paraqitet realizimi i buxhetit të bashkisë Berat sipas programeve në 000 lekë

Njesia								
Bashkia Berat								
Titulli i Progr.	Emertimi Programit	(1) Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(6) Fakti i 12-mujorit	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	106,854	166,371	166,371	159,895	105,561	54,335	66%
01120	Çështje financiare dhe fiskale	22,690	24,419	24,419	20,469	18,862	1,607	92%
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	7,267	8,413	8,413	8,413	7,321	1,092	87%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	9,840	12,542	12,542	11,262	9,411	1,851	84%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	32,663	40,781	40,781	46,087	31,750	14,337	69%
03600	Marrëdhëniet në komunitet	1,738	0	0	0	0	0	0%
04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	2,133	0	0	0	0	0	0%
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe veterinare	16,574	18,657	18,657	18,657	15,342	3,315	82%
04240	Menaxhimi i Infrastrukturaës së ujitjes dhe kullimit	17,475	24,279	24,279	24,434	19,228	5,207	79%
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	5,558	5,159	5,159	5,230	4,495	735	86%
04520	Rrjeti rrugor rural	153,959	166,769	166,769	166,888	102,380	64,508	61%
04570	Transporti publik	1,282	0	0	0	0	0	0%
04740	Projekte zhvillimi	3,731	6,390	6,390	12,800	10,386	2,414	81%
04760	Zhvillimi i turizmit	2,338	0	0	0	0	0	0%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	39,669	80,608	80,608	111,058	63,398	47,660	57%
06140	Planifikimi Urban Vendor	9,872	9,971	9,971	9,601	8,866	735	92%
06260	Shërbimet publike vendore	38,822	55,179	55,179	55,600	45,129	10,471	81%
06330	Furnizimi me ujë	12,568	6,000	6,000	6,000	0	6,000	0%
06440	Ndricim rrugësh	20913	34681	34681	39341	31702.4	7638.6	81%
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	7,949	1,512	1,512	1,512	0	1,512	0%
08130	Sport dhe argëtim	47,043	32,852	32,852	32,852	28,601	4,251	87%
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	41,642	40,085	40,085	40,085	24,541	15,544	61%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	182,619	222,469	222,469	223,719	198,679	25,040	89%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,146	13,579	13,579	13,817	13,049	768	94%
09240	Arsimi profesional	44,139	27,374	27,374	46,308	12,112	34,196	26%
10140	Kujdesi Social për personat me aftësi të kufizuar	24,320	23,731	23,731	26,595	23,701	2,894	89%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	33,616	46,241	46,241	46,654	38,051	8,602	82%
10661	Strehimi Social	3,888	7,208	7,208	7,525	4,023	3,502	53%
Totali		904,308	1,075,270	1,075,270	1,134,803	816,588	318,215	72%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi i buxhetit të bashkisë Berat sipas programeve për vitet 2019 dhe 2020

në 000 lekë

Titulli i Progr	Emertimi Programit	Viti 2019		Viti 2020		Krahasimi buxhet 2020-2019	
		Fakt 2019	Pesha ne strukt. %	Fakt 2020	Pesha ne strukt. %	në 000 lek	në %
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	106,854	12%	105,561	13%	-1,293	-1.2%
01120	Çështje financiare dhe fiskale	22,690	3%	18,862	2%	-3,828	-16.9%
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	7,267	1%	7,321	1%	54	0.7%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	9,840	1%	9,411	1%	-429	-4.4%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	32,663	4%	31,750	4%	-913	-2.8%
03600	Marrëdhëniet në komunitet	1,738	0%	0	0%	-1,738	-100.0%
04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	2,133	0%	0	0%	-2,133	-100.0%
04220	Shërbimet bujqësore, inspektimi, siguria ushqimore dhe mbr	16,574	2%	15,342	2%	-1,232	-7.4%
04240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	17,475	2%	19,228	2%	1,753	10.0%
04260	Administrimi i pyjeve dhe kullotave	5,558	1%	4,495	1%	-1,063	-19.1%
04520	Rrjeti rrugor rural	153,959	17%	102,380	13%	-51,579	-33.5%
04570	Transporti publik	1,282	0%	0	0%	-1,282	-100.0%
04740	Projekte zhvillimi	3,731	0%	10,386	1%	6,655	178.4%
04760	Zhvillimi i turizmit	2,338	0%	0	0%	-2,338	-100.0%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	39,669	4%	63,398	8%	23,729	59.8%
06140	Planifikimi Urban Vendor	9,872	1%	8,866	1%	-1,006	-10.2%
06260	Shërbimet publike vendore	38,822	4%	45,129	6%	6,307	16.2%
06330	Furnizimi me ujë	12,568	1%	0	0%	-12,568	-100.0%
06440	Ndricim rrugësh	20,913	2%	31,702	4%	10,789	51.6%
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	7,949	1%	0	0%	-7,949	-100.0%
08130	Sport dhe argëtim	47,043	5%	28,601	4%	-18,442	-39.2%
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	41,642	5%	24,541	3%	-17,101	-41.1%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	182,619	20%	198,679	24%	16,060	8.8%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,146	1%	13,049	2%	-97	-0.7%
09240	Arsimi profesional	44,139	5%	12,112	1%	-32,027	-72.6%
10140	Kujdesi Social për personat me aftësi të kufizuar	24,320	3%	23,701	3%	-619	-2.5%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	33,616	4%	38,051	5%	4,435	13.2%
10661	Strehimi Social	3,888	0%	4,023	0%	135	3.5%
	Totali	904,308	100%	816,588	100%	-87,720	-9.7%

Nga të dhënat shihet se niveli i realizimit të buxhetit të shpenzimeve sipas programeve është në varësi të burimit të financimit. Programet të cilat financohen me fonde me burim edhe nga të ardhurat e veta kanë një realizim mesatarisht 73%, që varion nga 53% në 87%, për arsye të mosrealizimit të të ardhurave në kushtet e pandemisë; programe si : Strehimi Social 53%, Menaxhimi i mbetjeve 57% , Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore 61%, Rrjeti rrugor 61%, Planifikim, menaxhim dhe administrim 66% , Ndricim rrugësh 81% , Shërbimet publike vendore 81%, Kujdesi social për familjet dhe fëmijët 82%, Shërbimet e Policisë Vendore 84%, Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm 87% , Sport dhe argëtim 87%, Çështje financiare dhe fiskale 92%, Planifikimi Urban Vendor 92%.

Programet të cilat financohen nga transferta specifike janë realizuar mesatarisht në masën 87%, nga 79 % deri në 94 %; programe si: Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit 79%, Shërbimet bujqësore 82%, Administrimi i pyjeve dhe kullotave 86%, Arsimi bazë 89% , Kujdesi Social për personat me aftësi të kufizuar 89% , Arsimi i mesëm i përgjithshëm 94%.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Paraqesim më poshtë realizimin e shpenzimeve në nivel programi dhe sipas njësive shpenzuese, objektivave të synuara , produkteve dhe aktiviteteve për çdo program.

NJËSIA SHPENZUESE: BASHKIA BERAT

Menaxhon 50 % të totalit të buxhetit të bashkisë, në programet :

- Planifikim menaxhim administrim, përfshirë fondin rezervë , emergjencën dhe kontigjencën, transferimin e kuotës së Këshillit të Qarkut , dhe transfertat të tjera për Ndërmarrjen Ujësjellës Kanalizime dhe Drejtorisë Rajonale të Tatimeve
- Çështjet financiare dhe fiskale
- Pagesa të shërbimit të borxhit të brendshëm
- Shërbimet e policisë vendore
- Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
- Marrëdhëniet në komunitet
- Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi
- Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
- Rrjeti rrugor rural
- Transporti publik
- Projekte zhvillimi
- Zhvillimi i turizmit
- Menaxhimi i mbetjeve
- Planifikimi urban vendor
- Shërbime publike vendore
- Furnizimi me ujë
- Shërbimet e kujdesit parësor
- Sport dhe argëtim
- Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore
- Arsimi bazë përfshi parashkollorin
- Kujdesi social për familjet dhe fëmijët
- Strehimi social



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Në pasqyrën e mëposhtme paraqitet realizimi i buxhetit 2020 të Njesisë Shpenzuese Bashkia Berat sipas programeve :

në 000 lekë

Titulli i Progr. amit	Emërtimi Programit	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e reali zimit
		Fakti	PBA	Buxheti Vjetor	Buxheti Vjetor	Plan Buxheti	Fakti	Diferenca	
		i vitit paraardhës Viti 2019	Plan Viti 2020	Plan Fillestar Viti 2020	Plan i Rishiku ar Viti 2020	8-mujor	i 12-mujorit		
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	98,045	155,785	155,785	149,309	111,880	96,986	52,324	65%
01120	Çështje financiare dhe fiskale	22,690	24,419	24,419	20,469	15,341	18,862	1,607	92%
01710	Pagesa për shërbimin e borxhit të brendshëm	7,267	8,413	8,413	8,413	5,800	7,321	1,092	87%
03140	Shërbimet e Policisë Vendore	9,840	12,542	12,542	11,262	8,185	9,411	1,851	84%
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile	32,663	40,781	40,781	46,087	33,167	31,750	14,337	69%
03600	Marrëdhëniet ne komunitet	1,738	0	0	0	0	0	0	0%
04160	Shërbimi i tregjeve, akreditimi dhe inspektimi	2,133	0	0	0	0	0	0	0%
04240	Menaxhimi i Infrastruktues së ujitjes dhe kullimit	3,556	2,500	2,500	2,500	2,000	0	2,500	0%
04520	Rrjeti rrugor rural	104,440	92,383	92,383	92,383	64,793	37,834	54,549	41%
04570	Transporti publik	1,282	0	0	0	0	0	0	0%
04740	Projekte zhvillimi	3,731	6,390	6,390	12,800	4,961	10,386	2,414	81%
04760	Zhvillimi i turizmit	2,338	0	0	0	0	0	0	0%
05100	Menaxhimi i mbetjeve	39,669	80,608	80,608	111,058	81,840	63,398	47,660	57%
06140	Planifikimi Urban Vendor	9,872	9,971	9,971	9,601	6,571	8,866	735	92%
06260	Shërbimet publike vendore	2,520	12,785	12,785	13,206	10,326	10,696	2,510	81%
06330	Furnizimi me ujë	12,568	6,000	6,000	6,000	4,500	0	6,000	0%
07220	Shërbimet e kujdesit parësor	7,949	1,512	1,512	1,512	1,512	0	1,512	0%
08130	Sport dhe argëtim	43,365	27,164	27,164	27,164	27,164	25,000	2,164	92%
08220	Trashëgimia kulturore, eventet artistike dhe kulturore	13,249	191	191	191	191	0	191	0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	17,184	27,236	27,236	28,453	24,236	27,000	1,453	95%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	10,637	13,973	13,973	14,385	9,485	13,324	1,061	93%
10661	Strehimi Social	3,888	7,208	7,208	7,525	5,153	4,023	3,502	53%
Totali Program 0110		450,624	529,861	529,861	562,318	417,105	364,856	197,462	65%

Programi 0110 : PLANIFIKIM, MENAXHIM DHE ADMINISTRIM

Vështrim i përgjithshëm : Zhvillimi i njësisë, menaxhimi i financave të njësisë së vetëqeverisjes vendore, të burimeve të tjera si dhe të burimeve njerëzore, funksionimi i proceseve të përgjithshme të brendshme dhe komunikimi me publikun. Shërbime në mbështetje të kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të këshillit;

Politika e Programit. Përmirësimi i efektivitetit dhe efikasitetit të administratës publike përmes Rritjes së efikasitetit dhe llogaridhënies së punonjësve publikë, modernizimit të institucioneve dhe shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, duke përfshirë rritjen e efikasitetit përmes zbatimit të zgjidhjeve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK).

Përmirësimi i procedurave administrative dhe mbikëqyrëse nëpërmjet rritjes së kontrollit të aktivitetit të administratës publike dhe sigurimit të të drejtave të qytetarëve dhe lehtësimi të procedurave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Përshkrimi i programit

- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
- Shërbime të përgjithshme publike, si: shërbimet e prokurimit, mbajtja dhe ruajtja e dokumenteve dhe arkivave të njësisë, ndërtesave në pronësi apo të zëna nga njësia, zyrave të printimit dhe IT etj.
- Administrim, funksionim dhe ofrimi i shërbimeve të mbështetjes për kryetarin e njësisë vetëqeverisjes vendore, për këshillin dhe komisionet e këshillit ose të kryetarit të njësisë.
- Shërbimet statistikore dhe baza e të dhënave vendore;
- Prodhim dhe përhapje e informacionit publik, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet për zhvillimin e komunitetit;

Ky program synon mbështetjen financiare dhe njerëzore në realizimin e funksioneve të Bashkisë.

Objektivat e politikës së programit: Aparati i Bashkisë ka si objektiv formalizimin, përmirësimin e punës, shërbimeve administrative dhe rritjen e transparencës. Për vitin 2020 në programin “ Planifikim, Menaxhim dhe Administrim” në funksion të veprimtarisë kryesore dhe përmbushjes së objektivave të përcaktuara për vitin 2020 janë analizuar si më poshtë:

Objektiv 1. Fuqizimi i kapaciteteve të burimeve njerëzore në Administratën e Bashkisë nëpërmjet rekrutimit sipas legjislacionit në fuqi sipas parimit të meritës, aftësive dhe profesionalizmit, që t’i përgjigjet standarteve më të larta që kërkohen për realizimin e objektivave, vizionit dhe misionit të Institucionit.

Aktiviteti 1. Rekrutimi i burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave të Bashkisë Berat për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Ky aktivitet synon rekrutimin e burimeve profesionale për të qenë pjesë e administratës vendore përmes procedurave të përcaktuara me ligj, në mënyrë transparente, me profesionalizëm, në bazë të meritave dhe aftësive profesionale.

Objektiv 2. Kualifikimi në vijueshmëri i burimeve njerëzore .

Aktiviteti 1. Ky aktivitet synon që nëpunësit civilë me qëllim përfitimin dhe përditësimin e njohurive shtesë, të identifikojnë nevojat dhe të kryejnë trajnime në institucione të tjera trajnuese me iniciativën e tyre, për detyrën që ata kryejnë, me propozimin e përbashkët të eprorit e të drejtuesit të njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit dhe me miratimin e titullarit të institucionit. Gjatë vitit 2020 për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19, nga ASPA u anuluan trajnimet pranë institucionit dhe u zhvilluan nëpërmjet platformave online. Punonjësit kanë marrë trajnimet profesionale të nevojshme sipas një kalendarit trajnimesh sipas konfirmimit të eprorëve.

Objektiv 3. Garantimi i realizimit në kohë të shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritja e cilësisë së shërbimit

Treguesi:

1. Zyra me një ndalesë, Arkivi , Marrëdhëniet me publikun, të cilët janë përgjegjës për informimin e qytetarëve, administrimin dhe depozitimin e kërkesave, lëvrimin e shërbimit/produktit si rezultat i kërkesës për shërbim dhe administrimin dhe depozitimin e ankesave ndaj shërbimit.

Produktet që u realizuan:

a) Rekrutimi i burimeve njerëzore në vendet e lira në strukturën e miratuar në mbështetje të planit vjetor të rekrutimit kryhet me procedurën e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese dhe pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Kjo procedurë realizohet përmes konkursit të hapur në zbatim të Ligjit Nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, VKM Nr. 242, datë 18/03/2015, VKM Nr. 243, datë 18/03/2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”. Procedurat e rekrutimit u anuluan për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19 referuar urdhërit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr.222, datë 01.04.2020. Pas heqjes së masave parandaluese Bashkia Berat vijoi me zhvillimin e procedurave të konkurimit në shërbimin civil.

b) Funksionimi i zyrës me një ndalesë si në Bashki qendër ashtu edhe në Njesitë Administrative . Zyra me një ndalesë cdo ditë ka administruar kërkesat e paraqitura nga qytetarët me seriozitet, me cilësi dhe profesionalizëm , i ka adresuar edhe në drejtoritë përkatëse për trajtim të specializuar, udhëhequr nga qëllimi për të bërë të mundur dhënien e informacionit, kthimin e përgjigjeve për zgjidhjen e problematikave, në një kohë sa më të shkurtër dhe me cilësi.

c) Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve nëpërmjet përmirësimit të kushteve të punës së administratës (blerja e



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

paisjeve kompjuterike për administratën).

- d) Përdorimi i sistemeve HRMIS, Administrata.al si pjesë e regjistrimit qendror të personelit të administratës vendore (me mbështetjen e DAP, ASPA, Këshillit të Evropës, Qeverisë Zvicerane) , pasi reforma në Administratë është një kusht i rëndësishëm për t'u përmbushur për hapjen e negociatave për në BE.
- e) Vazhdimi i funksionimit të sistemit E-PAV(platforma e administratës vendore) si një hallkë bashkëpunimi me ASPA për trajnimet e detyrueshme të nëpunësve civilë në periudhë prove.
- ë) Përmirësimi dhe Instalimi i sistemit të taksave (TAIS) edhe në njësitë administrative .
- f) Mirëmbajtje dhe Administrimi i sistemit elektronik i lejeve të ndërtimit , instalimi, konfigurimi i USB Token, Zyrës me një ndalesë, Info-Kioskat, Vendime.al.
- g) Përmirësimi i vazhdueshëm në drejtim të ndërtimit të një strukture organizative cilësore, për të përshtatur burimet njerëzore në shërbim të plotë të plotësisht të nevojave të qytetarëve.

Aktivitetet që u realizuan nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve korrente :

✓ Vazhdimësia e menaxhimit efektiv e administratës së Bashkisë në funksion të përmbushjes së misionit, qëllimeve dhe objektivave dhe përgjegjësi të Bashkisë Berat për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Kemi realizuar sigurimin e mbështetjes së funksionimit të administratës së Bashkisë Berat përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave sipas klasave e shtesave mbi pagë në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, brenda kufirit minimal dhe maksimal të miratuar , duke realizuar 85% të planifikimit, fakti 38,282,000 lekë / plani 45,009,000 lekë.

✓ Mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore (Këshilli i Bashkisë dhe Kryepaletë). U sigurua mbështetje për funksionimin e organeve të zgjedhura vendore. Është realizuar shpërblyeri mujor në mënyrë sistematike dhe me korrektësi për anëtarët e këshillit bashkiak dhe kryepaletë e njësisë administrative. Fondi i shpenzuar është 7,995,000 lekë , ose 96 % e planit prej 8,340,000 lekë.

✓ Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë, shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën. Është bërë furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime, dokumentacion, materiale për pastrim e dezinfektim zyra, etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën. Fondi i shpenzuar për këtë aktivitet është 1,239,000 lekë, ose 46% e planit prej 2,665,000 lekë.

✓ Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së Bashkisë. Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës së Bashkisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim internet etj. Realizuar energji elektrike 2,307,000 lekë, uji 987,000 lekë, shërbim postar, 841,000 leke, shërbime të tjera rregjistrim pronash, mirëmbajtje sistemi i taksave TAIS, shërbimi i internetit etj. 1,625,000 lekë. Fondi total i shpenzuar për këtë aktivitet është 5,760,000 lekë, ose rreth 92% e planit prej 6,281,000 lekë.

✓ Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e administratës së Bashkisë. Është realizuar blerja e karburantit dhe furnizimi sistematik me karburant i mjeteve të transportit për kryerjen e detyrave dhe funksioneve të përditshme të administratës vendore të Bashkisë sipas nevojave. Janë kryer shërbime të riparimit për të gjitha automjetet, pagesa e siguriacioneve, taksave të qarkullimit dhe kolauditimit vjetor të mjeteve të transportit në shërbim të administratës . Për vitin 2020 për shkak të vendosjes së masave parandaluese për përhapjen e covid-19, u reduktuan lëvizjet e mjeteve të transportit. Realizimi i shpenzimeve të transportit në shumën 1,776,000 lekë, ose 54% e planit prej 3,286,000 lekë.

✓ Udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë. Shërbimi për udhëtime e dieta për administratën vendore në funksion të kryerjes së shërbimeve në punë është i domosdoshëm në rritjen e standartit të plotësisht të kushteve të punës ndaj administratës si dhe anasjelltas, në rritjen e eficiencës së administratës për dhënien e kontributit dhe përfaqësimin e duhur të institucionit në takime pune, seminare, workshop-e brenda dhe jashtë vendit. Për realizimin e këtyre lëvizjeve bëhet gjatë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

gjithë vitit rimbursimi i shpenzimeve dhe dietave për administratën vendore në masën financiare që ligji e parashikon. Për vitin 2020 për shkak të vendosjes së masave parandaluese për përhapjen e covid-19, u reduktuan lëvizjet për këtë aktivitet. Takimet dhe ëorkshopot u zhvilluan përmes platformave online. Realizimi i shpenzimeve është në shumën 266,000 lekë / plan 1,500,000 lekë, ose në masën 18%.

✓ Organizimi i pritjeve të përfaqësuesve të institucioneve vendase dhe të huaja me qëllim vendosjen e marrëdhënieve dypalëshe me shumë institucione homologe të huaja, në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Për shkak të masave për parandalimin e përhapjes së COVID-19 ,organizimet e kësaj natyre u ndaluan dhe u reduktuan në pjesën më të madhe të vitit. Realizimi i shpenzimeve për këtë aktivitet është në shumën 68,000 lekë, ose 6% e planit prej 1,224,000 lekë.

✓ Shpenzime gjyqësore, të cilat janë likuaduar sipas grafikut të depozituar në degën e thesarit në fillim të vitit dhe publikuar edhe në faqen zyrtare të Bashkisë. Realizimi në shumën 24,119,000 lekë.

✓ Honorare për anëtarët e komisionit të shërbimit civil në shumën 100,000 lekë.

✓ Shpenzimeve të tjera operative. Shpenzime për aktivitete të ndryshme kulturore , në shumën 4,866,000 lekë.

✓ Realizimi i shpenzimeve operative të këtij programi është 53,718,000 lekë nga 66,847,000 të planifikuara, ose në masën 80 %.

Artikulli 604 : Transferta korrente të brendshme

Sqarimet për këtë artikull janë dhënë në faqen 17.

Artikulli 606 : Transferta për Buxhetet Familjare & Individë

Sqarimet për këtë artikull janë dhënë në faqen 17.

Artikulli 230-231 realizimi paraqitet në masën 3%; informacioni i detajuar jepet në aneksin nr.5, sipas objektivit të investimit dhe programit përkatës.

Realizimi i buxhetit të programit 01110 është masën 65%, fakt 96,986,000 lekë / plan 149,309,000 lekë.

Realizimi i buxhetit të programit 01110 paraqitet si më poshtë, në 000 lekë :

Emri i Grupit		Planifikim, menaxhim, Administrim						% e realizimi
Programi	01110							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhe s Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxhet i Vjetor Plan Fillesta r Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikua r Viti 2020	Fakti i 12- mujorit	Diferenc a	
600	Paga	37,033	38,666	38,666	38,616	32,999	5,617	85%
601	Sigurime Shoqërore	6,325	6,393	6,393	6,393	5,282	1,111	83%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	25,844	93,438	93,438	66,847	53,718	13,129	80%
603	Subvencione	0					0	
604	Transferta Korente të Brendshme	1,458	3,060	3,060	3,960	3,945	15	100%
605	Transferta Korente të Huaja	0					0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	645	7,500	7,500	26,765	854	25,911	3%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	71,306	149,057	149,057	142,581	96,800	45,782	68%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara	26,739	6,728	6,728	6,728	186	6,542	3%
232	Transferata Kapitalë						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitalë me financim të brendshëm	26,739	6,728	6,728	6,728	186	6,542	3%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara						0	
232	Transferata Kapitalë						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitalë me financim të huaj	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitalë	26,739	6,728	6,728	6,728	186	6,542	3%
Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti (Kapitull 6)							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		98,045	155,785	155,785	149,309	96,986	52,324	65%

Informacion për procedurat e prokurimit të vitit 2020 Drejtoria Juridike

Objektivat kryesore:

Objektiv 1: Sigurimin e të dhënave të nevojshme nga strukturat përkatëse në institucion dhe përgatitjen e regjistrave të parashikimeve për vitin 2020. Hedhja e të gjithë elementeve të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve Publike në sistemin elektronik të APP brenda afateve ligjore të parashikuara nga legjislacioni përkatës dhe vulosja e këtij regjistri pranë Degës së Thesarit Berat .

Objektiv 2: Realizimin e të gjitha prokurimeve Publike të parashikuara në regjister sipas afateve të përcaktuara.

Objektiv 3: Përgatitja e shtesave dhe ndryshimeve të regjistrave të parashikimeve të prokurimeve Publike gjatë vitit ,hedhja në sistemin elektronik të APP dhe vulosja e tyre pranë Degës së Thesarit Berat.

Objektiv 4: Nxjitjen e pjesëmarrjes dhe konkurrencës, së operatorëve ekonomik në procedurat e prokurimit publik, duke përgatitur kriteret dhe dokumentat standarte të tenderit në përputhje me kërkesat ligjore.

Objektiv 5: Bashkëpunimin mes zyrave të bashkisë për hartimin e specifikimeve, preventivave dhe kontrollit të tyre.

Objektiv 6: Asistenca ndaj komisionit të vlerësimit të ofertave, në rastet kur kërkohet nga vetë komisioni.

Objektiv 7: Përgatitja e procedurës së prokurimit, duke filluar që nga urdhri i prokurimit, përlllogaritjen e fondit limit (nëse nuk ka një komision të ngritur me urdhër të kryetarit posaçërisht për këtë qëllim), hartimin dhe publikimin e njoftimeve për botim brenda afateve ligjore, mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkalidhen dokumentave të tenderit (hartat, skicat, grafikun, planet etj).

Objektiv 8: Realizimin e procedurave të Prokurimit publik nga organi qendror blerës Bashkia Berat për llogari të Intitucioneve Vartese të Bashkisë në zbatim të urdhrit të brendshëm të Titullarit të Bashkisë

Objektiv 9: Kryerjen e inventarizimit të dosjeve të procedurave të prokurimit publik dhe dorëzimin e tyre në arkivin e Bashkisë.

Në regjistrin e parashikimeve Publike për vitin 2020 janë parashikuar gjithsej 55 procedura prokurimi (duke përfshirë dhe ndryshimet në regjister) nga të cilat janë realizuar 31 procedura prokurimi me vlerë e fondit limit 571 379 661.65 leke pa tvsh dhe vlerë e kontratave 556 854 998.58 leke pa tvsh, diferenca nga fondi limit prej 14 524 663.07 leke pa tvsh në total sipas llojit të procedurave si më poshtë:

1.Janë realizuar 8 procedura të mëdha me fond limit 558,075,775.65 leke pa tvsh dhe vlera e realizuar është 545 801 725.08 lekë pa tvsh, diferenca nga fondi limit në vlerën 12 274 050.57 (4 procedura tender I hapur dhe 4 kërkesë për propozime). Nder to 2 procedura blerje e përqëndruar nga autotiteti kontraktor, konkretisht: Blerje karburant për nevojat e Bashkisë dhe të institucioneve vartëse dhe Blerje pjesë këmbimi dhe shërbime për mjetet e transportit.

2.Është realizuar 1 procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të Kontratës me vlerë të fondit limit 5,914,000 lekë pa tvsh dhe vlera e kontratës 5,907,008 lekë pa tvsh, diferenca nga fondi limit 6,992 leke pa tvsh.

3. Janë realizuar gjithsej 14 procedura blerje me vlerë të vogël me fondi limit 6,804,335 lekë pa tvsh dhe vlera e realizuar është 4,652,531.5 lekë pa tvsh, diferenca nga fondi limit 2,151,803.5 lekë pa tvsh.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

4. Janë realizuar 8 procedura me vlerë nën 100,000 lekë, me fond limit 585 551 lekë pa tvsh dhe vlerë realizimi 493,734 lekë pa tvsh, diferenca nga fondi limit prej 91,817 lekë pa tvsh.

AUDITI I BRENDSHËM

Misioni i auditimit të brendshëm është të japë siguri të arsyeshme për titullarin e njësive të sektorit publik, në mënyrë të pavarur dhe objektive, si dhe këshilla për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sektorit të kontrollit të brendshëm në njësinë e sektorit publik.

Për vitin 2020 u planifikuan për auditim 10 njësi, nga të cilat 6 njësi me bilanc më vete, dhe 4 njësi shpenzuese, drejtori e njësi administrative. Janë realizuar gjithsej 9 auditime, pra realizuar 1 auditim më pak për shkak se për një periudhë 9 muajore është punuar me dy auditues, pasi një punonjëse është transferuar në një institucion tjetër jashtë bashkisë, si dhe për shkak të pandemisë së covidit.

Subjektet e audituara për vitin 2020 janë: “Drejtoria Ekonomike e Arsimit”, “Drejtoria Juridike dhe e Prokurimeve publike”, “Drejtoria e Emergjencave Civile dhe Pronave”, “Drejtoria e Financës për detyrimet e prapambetura”, “Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit”, “Qendra Lira”, “Drejtoria e Financës” për letrat me vlerë e normativat e karburantit”, “Policia Bashkiake”, dhe “Drejtoria e Planifikimit të Territorit, Investimeve e Kontrollit të Projekteve”.

Rezultatet dhe produktet e veprimtarisë së auditimit të brendshëm të pasqyruara në raportet e auditimit janë detajuar e analizuar sipas të gjithë hapave që përcaktohen në Manualin e Auditit të Brendshëm të miratuar me Urdhërin nr 100, datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave si dhe në Standartet Ndërkombëtare të Auditimit të pranuar.

Nga 9 angazhime auditimi të realizuara sipas llojit të auditimit janë realizuar 4 auditime të përputhshmërisë, 1 auditim financiar dhe 4 auditime të kombinuara.

Gjetjet Kryesore sipas Sistemeve

Për Vitin 2020 krahas punës së mirë, në njësitet publike që kemi audituar, janë konstatuar dhe të meta e mangësi si dhe shkelje të disipline financiare me dëm ekonomik.

Në zbatim të nenit 16, germa c të ligjit nr 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, për ndreqjen e parregullsive për subjektet e audituara kemi rekomanduar masa organizative, masa për zhdëmtim të cilat kanë synuar të ulin mundësinë e përsëritjes në të ardhmen, konkretisht:

Gjetjet me dëm ekonomik për vitin 2020 kanë qenë në shumën 3,576,000 lekë, ose 32% më shumë se viti 2019.

Rekomandimet për zhdëmtim gjithsej sipas sistemeve janë sipas tabelës së mëposhtme:
000/ leke.

Nr	Fusha e Zbulimit	Viti 2019			Viti 2020		
		Zhdemt Lekë	Nr Person	% Zbulim	Zhdemt Lekë	Nr Person	% Zbulim
1	Sistemi i pagave, shperblime, trajtime	508	48	19	460	35	12.9
2	Sistemi i prokurimeve, blerje, investime.	147	3	6	1165	17	32.6
3	Sistemi i tatim, taksa , doganë	2040	50	75	1951	8	54.5
4	Sistemi i kontabilitetit	0	0	0	0	0	0
5	Urbanizim, legalizim, kthim prone	0	0	0	0	0	0
	Shuma	2695	101	100	3576	60	100

Peshën më të madhe të zbulimeve në masën 54.5 % të rekomandimeve për zhdëmtim nga 60 persona fizik e juridik, e zënë zbulimet në fushën e sistemit të tatim taksave që vijnë kryesisht nga moszbatimi drejt i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar dhe të Ligjit nr 9920 datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”;

- Në sistemin e prokurimeve, blerjeve dhe investimeve në shumën 1.165 mijë ose në masën 32.6% të gjithë rekomandimeve për zhdëmtim për vitin 2020.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

- Në sistemin e pagave, shperblime etj, ne masën 12.9% për 35 punonjës, qe kane ardhur kryesisht nga mospagesa e punonjesve sipas klasifikimit te diplomave , paga e grupit, vjetersia ne pune, pagesa e oreve te mbikohes se punes, etj. shkelje të VKM nr 472, datë 02.07.2011 “ Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, VKM nr 997, datë 10.12.2010 „ Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit“, të ndryshuar, etj,

Këto shkelje e të meta kanë ardhur kryesisht nga mosnjohja e dispozitave ligjore, interpretimi i gabuar, llogaritja e gabuar e pagesave si dhe mungesa e dokumentacionit justifikues në bazë të dispozitave ligjore etj.

Deri me date 12.02.2021 nga 3 milion e 576 mijë lekë lekë kërkuar për zhdëmtim janë arketuar 1milion e 651 mijë e 300 lekë nga 17 persona fizikë e juridik, ose realizuar në masën 46.2 %. Arketimet vazhdojnë.

Për vitin 2020 në bazë të gjetjeve e parregullsive të identifikuara sipas sistemeve kemi rekomanduar gjithsej 94 rekomandime.

Konkretisht:

Rekomandimet e dhëna sipas sistemeve, rekomandimet e pranuar , rekomandimet e zbatuara dhe ato ne proces janë si më poshtë:

Në numër

Nr	Rekomandimet sipas Sistemeve	Numri Rekomandimeve	Pranuar	Zbatuar	Proçes
1	Rekomandim Përmirësim Sistemi Kontroll Brendsh.	28	28	16	12
2	Rekoman.Përmirësim Kuadri Ligjor	5	5	1	4
3	Rekomandime Karakteri Organizativ	42	42	12	22
4	Rekomandime për Arkëtim	16	16	1	11
5	Rekomandime të tjera	3	3	1	0
	Shuma	94	94	31	49

Rekomandimet më të shumta kemi në sistemin organizativ në 42 raste ose 45 % të rekomandimeve gjithsej, rekomandimet për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm në 28 raste, ose ne masën 30% të gjithë rekomandimeve.

Duhet theksuar se të gjitha rekomandimet për zhdëmtim dhe për përmirësim sistemesh janë pranuar nga titullaret e subjekteve të audituara. Nga rekomandimet e lëna rezulton se per vitet 2020 nga 94 rekomandime jane realizuar 31 rekomandime, ose realizuar rreth 33 % e tyre, në proces janë 52 e rekomandime dhe pa zbatuar deri me datë 12.02.21 janë 14 rekomandime kryesisht per shkak te ristrukturimit dhe koha e shkurter e zbatimit të rekomandimit të fundit nga auditit dhe zbatimit nga njesit e audituara.

Rëndësi në auditim u kemi kushtuar trajtimit të sistemeve me risk të lartë dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim të sistemit të kontrollit të brendshëm në të gjitha fushat e aktivitetit.

Programi 01120 : ÇËSHTJE FINANCIARE DHE FISKALE

Politika e programit : Forcimi i financave vendore nëpërmjet përmirësimit të menaxhimit fiskal në nivel vendor. Zbatimi efikas i buxhetit dhe rritja e të ardhurave, duke formalizuar ekonominë nëpërmjet reduktimit të ekonomisë informale dhe rritjes së të ardhurave nga tatimet.

Pershkrimi i programit:

- Administrim i çështjeve dhe shërbimeve financiare dhe fiskale; menaxhim i fondeve të njësisë së vetëqeverisjes vendore etj.
- Operacionet e thesarit të njësisë, zyra e buxhetit, administrata e të ardhurave, shërbimet e kontabilitetit dhe auditit;
- Prodhim dhe shpërndarje e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik për çështjet dhe shërbimet financiare dhe fiskale.

Objektivat e politikës së programit:

- Hartimi i politikave për rritjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat në zbatim të paketës fiskale dhe planit të të ardhurave në funksion të realizimit të buxhetit të bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

b. Rritja e të ardhurave të bashkisë nëpërmjet një menaxhimi sa më të mirë të pronave të bashkisë, rritjen e numrit të pronave të regjistruara në Z.R.P.P, me qëllim rritjen e numrit të ambienteve të dhëna me qira ose kontrata të tjera si dhe monitorim sa më efikas i tyre.

c. Rritja e konkurrueshmërisë së bizneseve dhe punësimit në vend, duke forcuar kapacitetet institucionale dhe përmirësimi i klimës së biznesit përmes dhënies dhe aksesit të lehtësuar të informacionit për të bërë biznes në Berat.

d. Politika lehtësuese për bizneset e hapura, nga familjet e reja, dhe të drejtuara nga gra, në vitin e parë të ushtrimit të aktivitetit, për të gjitha Njësitë Administrative.

Produktet që u synuan të ofrohen

✓ Shtrirja e Sistemit Informatik të Administrimit të Taksave (TAIS) edhe në njësitë administrative Roshnik, Sinjë, Velabisht dhe Otllak. (për bizneset).

✓ Përmirësimi i sistemit të programit të administrimit të taksave vendore TAIS me elementë të tjerë.

✓ Përmirësimi i produktivitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të punonjësve duke zhvilluar dhe përdorur më mirë aftësitë dhe potencialin e tyre.

✓ Sigurimi i programeve trajnuese për rritjen e kapaciteteve të njohurive dhe aftësive të personelit.

Realizimi i buxhetit të programit 01120 është 18,862,000 lekë nga 20,469,000 të planifikuara, ose në masën 92 %.

Realizimi i buxhetit të programit 01120 paraqitet si më poshtë , në 000 lekë :

Emri i Grupit	Ceshtje financiare dhe fiskale								% e realizimit
Programi	01120								
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Plan Buxheti 8-mujor	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	19,581	20,954	20,954	17,504	13,088	16,147	1,357	92%
601	Sigurime Shoqërore	3,019	3,465	3,465	2,965	2,253	2,715	250	92%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera							0	
603	Subvencione							0	
604	Transferta Korente të Brendshme							0	
605	Transferta Korente të Huaja							0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ	90						0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	22,690	24,419	24,419	20,469	15,341	18,862	1,607	92%
230	Kapitale të Patrupëzuara							0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0	
232	Transferta Kapitale							0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	0	0	0	0	0	0	0%
230	Kapitale të Patrupëzuara							0	
231	Kapitale të Trupëzuara							0	
232	Transferta Kapitale							0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0	0%
Totali	Shpenzime Kapitale	0	0	0	0	0	0	0	0%
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti (Kapitull 6)								0	0%
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		22,690	24,419	24,419	20,469	15,341	18,862	1,607	92%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Programi 1710 : PAGESA TË SHËRBIMIT TË BORXHIT TË BRENDSHËM

Projekti: “Ndërtimi i Banesave me Qëllim Social”

Në bazë të marrëveshjes së nën-huasë së nënshkruar midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Bashkisë Berat, në të cilën janë përcaktuar kështu vjetore të shlyerjes, kemi :

- Vlera totale e kredisë së disbursuar është 587,707 €
- Afati i shlyerjes së kredisë : 12/2014 – 07/2026
- Vlera e mbetur e pashlyer e kredisë në datën 31.12.2020 është 232,053 €.

Në vitin 2020 janë shlyer kështu e kredisë në shumën 58,770.70 €, e barazvlefshme me 7,321,000 lekë.

Buxheti i parashikuar për këtë program 8,413,000 lekë. Diferenca e mosrealizimit përfaqëson ndryshimin në kursin e këmbimit në datat e shlyerjes së kësteve dhe datës së planifikimit.

Programi 03140 : SHËRBIMET E POLICISË VENDORE

Administrimi i çështjeve dhe shërbimeve policore që janë të nevojshme për kryerjen e funksioneve në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së punëve publike, parandalimin dhe zbulimin e informalitetit brenda territorit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Politika e programit: Përmirësimi i cilësisë së ofrimit të shërbimeve dhe rritja e besimit të publikut, nëpërmjet uljes së në kohës së përgjigjes së policisë ndaj thirrjeve të komunitetit dhe rritjes të numrit të thirrjeve të publikut

Përshkrimi i programit:

- Sigurimi i mbrojtjes, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të njësisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;
- Parandalimi i kundravajtjeve administrative, forcimi , inspektimi dhe monitorimi i zbatimit të rregulloreve e të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe i vendimeve të Këshillit Bashkiak brenda juridiksionit vendor dhe në përputhje me përcaktimet ligjore.

Produktet që u synuan të ofrohen :

Gjatë vitit 2020, krahas punës për monitorimin e situatës në terren, ndjekjen dhe zbatimin e detyrave rutinë të ngarkuara me ligj, zbatimin e vendimeve të Këshillit Bashkiak dhe urdhërave të Kryetarit të Bashkisë, Policia Bashkiake menjëherë pas shfaqjes së rasteve të para të pandemisë COVID-19, në zbatim të detyrimeve ligjore të dala për përballimin e kësaj situatë është angazhuar maksimalisht në sigurimin e zbatimit të rregullave kufizuese dhe distancimin social në tregje dhe ambiente të tjera të ushtrimit të aktiviteteve tregtare, sportive , publike, kulturore,etj. Janë organizuar shërbime të përbashkëta me policinë e shtetit dhe struktura të tjera ligjzbatuese për kontrollin e lëvizjes së mjeteve dhe personave gjatë periudhës së izolimit gjatë pandemisë, si dhe është angazhuar maksimalisht në bashkëpunim me shërbimet sociale për identifikimin e personave apo familjeve në nevojë emergjente për ndihmë, shpërndarjen e ndihmave nëpër banesa sipas grafikut të përcaktuar etj. Ka siguruar zbatimin e urdhërave të Kryetarit për regjimin e lëvizjes brenda institucionit të Bashkisë duke respektuar rregullat e vendosura për mbrojtjen nga virusi covid-19.

Aktivitetet që u realizuan nëpërmjet kryerjes së shpenzimeve korrente :

- ✓ Mbështetje e funksionimit të strukturës së policisë bashkiake përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, për 16 punonjës (nga 16 punonjës në strukturë) , duke realizuar 93% të planifikimit, fakti 9,082,000 lekë / plani 9,737,000 lekë.
- ✓ Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e Policisë Bashkiake. Në funksion të policisë Bashkiake është një automjet, i cili në vitin 2020 ka pasur nevojë për furnizim karburanti, shërbim të kontrollit teknik, pagesën e taksave dhe siguracionit , të cilat janë realizuar në vlerën 329,025 lekë, ose 44% e planit prej 750,000 lekë.
- ✓ U planifikuan 700,000 lekë për blerje uniforma; procedura e prokurimit për këtë artikull nuk u krye për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

mungesë fondesh.

Realizimi i buxhetit të programit 03140 është masën 84%, fakt 1,851,000 lekë / plan 11,262,000 lekë.

Realizimi i buxhetit të programit 03140 paraqitet si më poshtë, në 000 lekë :

Emri i Grupit								% e reali zimit
Program i	Shërbimet e Policisë Vendore							
	03140							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardh es Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishiku ar Viti 2020	Fakti i 12-mujor it	Difere nca	
600	Paga	7,560	9,454	9,454	8,354	7,783	571	93%
601	Sigurime Shoqërore	1,309	1,563	1,563	1,383	1,299	84	94%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	287	1,450	1,450	1,450	329	1,121	23%
603	Subvencione						0	
604	Transferta Korente të Brendshme						0	
605	Transferta Korente të Huaja						0	
606	Transf. per Buxh. Fam. & Individ		75	75	75	0	75	0%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	9,156	12,542	12,542	11,262	9,411	1,851	84%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara	684					0	
232	Transferta Kapitalë						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitalë me financim te brendshem	684	0	0	0	0	0	0%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara						0	
232	Transferta Kapitalë						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitalë me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	0%
Totali	Shpenzime Kapitalë	684	0	0	0	0	0	0%
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti (Kapit 6)							0	0%
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		9,840	12,542	12,542	11,262	9,411	1,851	84%

Programi 03280 : MBROJTJA NGA ZJARRI DHE SHPËTIMI

Garantimi i shërbimit zjarrfikës në nivel vendor dhe administrimi i strukturave përkatëse; Parandalimi, mbrojtja nga zjarri dhe përbalimi i emergjencave të tjera që vijnë nga rreziqet natyrore ose aksidentet e trafikut rrugor.

Objektivat:

- Funksionimi i njësive zjarrfikëse dhe i shërbimeve të tjera të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
- Mbështetja e programeve trajnuese të parandalimit dhe mbrojtjes kundër zjarrit;
- Shërbimi i Mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi;

Mbrojtja Civile dhe administrim i strukturave përkatëse; Shërbimet e mbrojtjes civile, si shpëtimet malore, vrojtimi i plazheve, evakuimi i zonave të përmbytura etj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Në zbatim të ligjit 152/2015, date 21.12.2015, Drejtoria M.Z.Sh-se duke qene srukture operuese/inspektuese ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin, ka vepruar per zbatimin me korrektesi dhe pergjegjshmeri te detyrave dhe ka per qellim permbushjen sipas objektivave te vena qe ne fillim te vitit, nepermjet inspektimit dhe parandalimit te masave te mbrojtjes nga zjarri.

Misioni i ketij sherbimi eshte inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin, nderhyrja per shuarjen e zjarreve, shpetimi i jetes, prones, gjese se gjalle, mjedisit, pyjeve dhe kullotave ne aksidenteve te ndryshme, fatkeqesive natyrore, e ato te shkaktuara nga dora e njeriut.

Gjate zbatimit te buxhetit te vitit 2020 per zbatimin me korrektesi dhe pergjegjshmeri te detyrave, si dhe realizimin e objektivave, nga sektoret e Drejtorise se M.Z.Sh-se jane kryer:

1. Sektori i Inspektimit dhe Parandalimit, gjate vitit 2020 ka realizuar nje volum pune prej 306 inspektimesh ne objekte te ndryshme si shkolla, kopshte, cerdhe, dyqane, magazina, hotele, karburante, depozita gazi, objekte historike e administrative etj. Jane kryer 86 Akt-kontrolle e 1 Gjobe. Jane perpiluar 44 Akt-teknike, nga ku 17 Akt-teknike fillestare dhe 27 Akt-teknike Riperteritje. Gjithashtu jane kryer 11 Ekspertiza, 15 Miratim leje objektesh, 5 Vertetime zjarri.

2. Sektori i stervitjes dhe trajnimit, gjate vitit 2020 janë trajnuar gjithsej 267 persona.

Janë trajnuar :

- ✓ 15 mësues dhe 40 nxënës
- ✓ 74 punonjës fasonerie
- ✓ 49 punonjës të Spitalit Rajonal
- ✓ 12 punonjës të Policisë Bashkiake
- ✓ 18 punonjës në Drejtorinë e Bujqësisë
- ✓ 16 punonjës të A.D. Z.M.
- ✓ 43 punonjës të grupeve vullnetare në njësinë administrative Roshnik, Otlak, Sinjë.

Në bashkëpunim me Drejtorinë e Ujesjellës Kanalizimeve Berat, është realizuar verifikimin mbi gjendjen teknike te hidranteve, janë vendosur ne gjendje pune hidrantet si dhe janë zhvilluar prova gadishmërie në lagjet e Qytetit të Beratit , për përdorimin nga ana e efektivit zjarrefikes, mbi gjendjen teknike te hidranteve. Nga dita e hënë deri të enjte në Drejtorinë e M.Z.SH-së zhvillohet stervitja me efektivin zjarrefikes, me qellim pregatitjen e efektivit per t'iu përgjigjur situatave të zjarreve dhe nderhyrjeve te ndryshme.

3. Sektori për Shuarjen e Zjarrit dhe Shpëtimin, gjatë vitit 2020 ka realizuar 344 nderhyrje ,nga te cilat 58 per shpetim dhe 21 per shuarje zjarri. Nderhyrjet kane qene ne objekte banimi, ne dyqane e magazina te ndryshme, ne objekte akomoduese, ne mjete transporti, ne pyje kullota, barishte etj. Gjithashtu ka pasur edhe nderhyrje per shpetim personi kur kane qene te plagosur dhe kane pasur nevojë per ndihmë nga ana e sherbimit zjarrefikes. Ne keto nderhyrje kane punuar 6 automjete, nga te cilat 3 zjarrefikese (duke perfshire edhe nje automjet tip Volvo, i cili iu shtua flotes se mjeteve zjarrefikese gjate vitit 2020), 1 autoshkalle, 1 automjet shpetimi, si dhe nje automjet mbeshtetes per nderhyrje ne rruge. Gjithashtu kane punuar dhe 2 motopompa, nga te cilat 1 thithese dhe tjetra perdoret per shuarje zjarri e vendosur ne automjetin tip Iveko. E gjithë kjo teknike ka pershkruar 5303 km. Konsumi i karburantit per keto automjete ka qene 8530 Litra naftë dhe 340 Litra benzine.

Pervec nderhyrjeve ne territorin e administruar nga Bashkia Berat, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin, ka kryer nderhyrje ne raste emergjence edhe ne Bashkine Skrapar, si dhe Bashkine Ura-Vajgurore (Dimali) per zjarret e ndodhura gjate vitit 2020.

Shpenzimet korrente u kryen për të realizuar aktivitetet :

✓ Mbështetje e funksionimit të strukturës përmes realizimit në kohë të shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shëndetësore. Zbatimi i buxhetit për shpenzime personeli u bazua tek numri i punonjësve dhe nivelet e pagave në përputhje me aktet nënligjore në fuqi, për 33 punonjës nga 38 punonjës në strukturë) , duke realizuar 76 % të planifikimit, fakti 26,394,000 lekë / plani 34,859,000 lekë.

✓ Plotësimi i kërkesave për kushte normale të punës në administratë, shërbim me kancelari dhe shtypshkrime për administratën. Është bërë furnizimi i vazhdueshëm me kancelari, letër, bojë, shtypshkrime etj për t'iu mundësuar punonjësve përmbushjen e detyrave administrative për të gjithë administratën. Fondi i shpenzuar për këtë aktivitet është 46,000 lekë nga 46,000 lekë të planifikuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- ✓ Mbështetja dhe ofrimi i shërbimeve bazë për funksionimin administratës së MZSH. Është përmirësuar funksionimi normal i të gjithë administratës nëpërmjet ofrimit të shërbimeve mbështetëse bazë si ujë, energji elektrike, ngrohje, komunikim postar, shërbim interneti etj. Realizimi i shpenzimeve për shërbime nga të tretët, energji elektrike 439,768 lekë, furnizim me ujë 236,782 lekë, shërbim interneti e 17,280 lekë. Shpenzime të realizuara fakt 693,830 lekë / plan 930,000 lekë, ose 75%.
- ✓ Mbështetje dhe ofrim i shërbimit të transportit për funksionimin e MZSH. Në funksion të MZSH janë 7 automjete, të cilat në vitin 2020 janë furnizuar rregullisht me karburant, u është kryer shërbimi i kontrollit teknik, pagesa e taksave dhe siguracionit . Shpenzimet e transportit janë realizuar në vlerën 1,923,341 lekë nga 2,770,00 të planifikuara, ose në masën 69.4%
- ✓ U planifikuan 670,000 lekë për blerje uniforma dhe të tjera materiale speciale; procedura e prokurimit për këtë artikull nuk u krye
- ✓ Shpenzime gjyqësore në shumën 378,500 lekë.
- ✓ Shpezime të tjera. Është paguar për siguracionin e jetës së punonjesve të MZSH në shumën 625,000 lekë.

Shpenzimet kapitale

Realizimi 100% , fakt 1,696,00 lekë / plan 1,696,000 lekë

Në këtë program përfshihet projekti “Kosto lokale, TVSH për blerje automjet zjarrfikës” me vlerë 1,696,000 lekë. Ky projekt është realizuar plotësisht në vitin 2020. (Blerja e mjetit është realizuar me fonde të sponsorizuara nga Ambasada Japoneze në Shqipëri. (Shuma e sponsorizimit : 9,248,000 lekë)

Realizimi i buxhetit të programit 03280 është në masën 69 %, fakt 31,750,000 lekë / plan 46,087,000 lekë.

Realizimi i buxhetit të programit 03280 paraqitet si më poshtë, në 000 lekë :

Emri i Grupit	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile							% e realizimit
Programi	03280	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
Art.	Emertimi	Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
600	Paga	25,954	29,913	29,913	29,913	22,645	7,268	76%
601	Sigurime Shoqërore	4,349	4,946	4,946	4,946	3,750	1,196	76%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,292	4,226	4,226	9,532	3,660	5,872	38%
603	Subvencione						0	
604	Transferta Korente të Brendshme						0	
605	Transferta Korente të Huaja						0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	68					0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	32,663	39,085	39,085	44,391	30,054	14,337	68%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara		1,696	1,696	1,696	1,696	0	100%
232	Transferta Kapitale						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	0	1,696	1,696	1,696	1,696	0	100%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara						0	
232	Transferta Kapitale						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale	0	1,696	1,696	1,696	1,696	0	100%
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti (Kapitull 6)							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		32,663	40,781	40,781	46,087	31,750	14,337	69%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Programi 5100 : MENAXHIMI I MBETJEVE

Programi i Menaxhimit të mbetjeve parashikon mbledhjen, grumbullimin, transportimin e mbetjeve urbane dhe inerte të qytetit nga vendgrumbullimet deri në pikën e vend depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit; pastrimin e rrugëve, shesheve, rrugicave, tregjeve, kopshteve publike, parqeve etj. Ky shërbim është shtrirë edhe në njësitë administrative të bashkisë.

Shërbimi i pastrimit në Bashkinë Berat dhe 4 Njësitë Administrative realizohet nga subjekti kontraktor Ante-Group shpk, sipas kontratës së shërbimit të datës 25.04.2019, kontratë e lidhur për periudhën 5 vjetare 2019-2024.

Gjatë vitit 2020 shërbimi i pastrimit u organizua në 4 (katër) zona funksionale si më poshtë :

- Zona 1 - Qyteti Berat, ku numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve është 300 kontenierë
- Zona 2 - Njësia Administrative Otllak, ku numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve është 59 kontenierë
- Zona 3 - Nj.A Sinjë & Velabisht, ku numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve është 89 kontenierë
- Zona 4.- Nj.A Roshnik & Fshati Duhanas, ku numri i pikave të grumbullimit të mbetjeve është 30 kontenierë

Zgjerim i shërbimit në territor;

- Përmirësimi i frekuencave të evadimit të mbetjeve : Qyteti i Beratit 7 ditë në javë, Nj.A. Otllak 4 herë në javë, Nj.A. Velabisht & Roshnik 2 herë në javë;
- Shtim i pikave të grumbullimit;
- Shtim i kontenierëve me 100 copë
- Zbatim i sistemit të monitorimit të shërbimit në të gjithë territorin;
- Sensibilizim i popullatës për shërbimin, ruajtjen e mjedisit, bashkëpunimin për një qytet të pastër;

Shpenzimet Korrente

Realizimi 57%, fakt 56.399.000 lekë / plan 98.614.000 lekë

Buxheti për shërbimin e pastrimit në vitin 2020 është planifikuar 98,614,000 lekë, nga të cilat 68,164,000 lekë për shërbimin e pastrimit të vitit 2020 dhe 30,450,000 për faturat e palikujduara të vitit 2019. Gjatë vitit 2020 janë likikujduar 56,399,000 lekë, ose realizim në masën 57 %. Vlera e faturave të palikujduara 42,215,000 lekë, është parashikuar në buxhetin e vitit 2021 të këtij programi.

Shpenzime Kapitale

Realizimi 56%, fakt 6,999,000 lekë / plan 12,444,000 lekë

Ky program ka në përmbajtje të tij 2 projekte :

1)“Blerje Kontenierësh” projekt me vlerë 17,208,000 lekë. Viti i fillimit 2019 dhe viti i përfundimit 2021. Në buxhetin e vitit 2020 shuma e parashikuar për këtë projekt është 9,000,000 lekë. Janë kryer likujdime në shumën 3,600,000 lekë për vlerën e 100 kontenierëve të blerë. Diferenca 5,400,000 lekë nuk është likujduar për mungesë fondesh. (Blerja e kontenierëve është pjesë e kontratës me kontraktorin e shërbimit të pastrimit Ante-Group shpk)

2)“Rehabilitim i rrugës inerte projekti Menaxhim i mbetjeve të ngurta”, projekt me vlerë totale të kontraktuar 21,486,000. Viti i fillimit të projektit 2020 dhe viti i mbarimit 2021. Në buxhetin e vitit 2020 shuma e parashikuar për këtë projekt është 3,444,000 lekë, e cila është realizuar/likujduar 3,399,000 lekë (vlera e situacionit të punimeve të kryera).

Realizimi i buxhetit të programit 05100 është në masën 57 %, fakt 63,398,000 lekë / plan 111,058,000 lekë. (Shërbimi është kryer 100 % sipas kontratës, por nuk janë likujduar faturat për arsye të mungesës së fondeve)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi i buxhetit të programit 5100 paraqitet si më poshtë, në 000 lekë :

Emri i Grupit	Menaxhimi i mbetjeve							% e realizimit
Programi	05100							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12- mujorit	Diferenca	
600	Paga	2,071					0	
601	Sigurime Shoqërore	380					0	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	35,350	68,164	68,164	98,614	56,399	42,215	57%
603	Subvencione						0	
604	Transferta Korente të Brendshme						0	
605	Transferta Korente të Huaja						0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	68					0	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	37,869	68,164	68,164	98,614	56,399	42,215	57%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara	1,800	12,444	12,444	12,444	6,999	5,445	56%
232	Transferta Kapitale						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	1,800	12,444	12,444	12,444	6,999	5,445	56%
230	Kapitale të Patrupëzuara						0	
231	Kapitale të Trupëzuara						0	
232	Transferta Kapitale						0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale	1,800	12,444	12,444	12,444	6,999	5,445	56%
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti (Kapitull 6)							0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		39,669	80,608	80,608	111,058	63,398	47,660	57%

Programi 06260 : MIRËMBAJTJE E VARREZAVE PUBLIKE DHE VARREZAVE TË DËSHMOREVE

Shërbimi i mirëmbajtjes së Varrezave Publike gjatë vitit 2020 është realizuar me sipërmarrje private me kontratë 5-vjeçare me kontraktorin AB Zoga shpk. Shërbimet kryesore të kryera janë:

- Pastrim parcelash dhe rrugësh të brendshme ndërmjet parcelave
- Mbjellje drurësh dekorativë
- Mbjellje në parcela bordurë e gjelbër
- Shërbimi i ruajtjes së varrezave publike dhe ato të dëshmorëve

Realizimi i buxhetit të këtij projekti është në masën 62 %, fakt 3,258,000 lekë / plan 5,218,000 lekë.

Realizimi i buxhetit për shpenzimet operative në programin 06260 paraqitet si më poshtë , në 000 lekë:

								% e realizimi
Emri i Grupit	Mirëmbajtje e varrezave publike							
Programi	06260							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	1,714	3,258	3,258	5,218	3,258	1,960	62%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

• **Detyrimet e prapambetura** : Njësia shpenzuese Bashkia Berat (aparati) mbyll vitin buxhetor 2020 me detyrime të prapambetura sipas UMFE nr. 37 datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”, në shumën 113,627,868 lekë, të përbërë nga detyrime për investime 82,948,474 lekë, detyrime për mallra dhe shërbime 20,703,206 lekë, detyrime për vendime gjyqësore 9,724,648 lekë, detyrime të tjera 251,540 lekë,

NJËSIA SHPENZUESE : NDËRMARRJA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Menaxhon 10% të buxhetit të bashkisë , në dy programe:

1. Programi 4520: Rrjeti rrugor rural
2. Programi 6440: Ndricim rrugësh

Realizimi në total i buxhetit 2020 për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në 000 lekë

Tit Progr	Emërtimi i Programit	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e reali zimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
	Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	70,432	109,067	109,067	113,846	96,248	17,598	84.5%
04520	Rrjeti rrugor rural	49,519	74,386	74,386	74,505	64,546	9,959	86.6%
06440	Ndricim rrugesh	20,913	34,681	34,681	39,341	31,702	7,639	80.6%

Programi 4520 : RRJETI RRUGOR RURAL

Politika e këtij programi konsiston në ofrimin e një infrastrukture sipas standardeve bashkëkohore në të gjithë komponentët e saj, të shtrirë në të gjithë qytetin, me qëllim që t’iu mundësojë qytetarëve qarkullim normal në ecjen e këmbësorëve dhe qarkullimin e mjeteve, krijimin e kushteve infrastrukturore dhe organizative për një mirëmbajtje të vazhduar të sistemit të ndicimit publik. Mirëmbajtja e rrugëve rurale.

Objektivat e Programit për vitin 2020 :

- Ofrimi i një shërbimi cilësor në mirëmbajtjen e rrugëve urbane, trotuareve, sinjalistikës rrugore si dhe sistemit të kanalizimit të ujërave të bardha , mirëmbajtjen e trotuareve, kalldrëme ekzistuese si dhe shtimin e sipërfaqeve të reja.
- Ofrimi i një shërbimi cilësor në mirëmbajtjen e rrugëve rurale
- Zëvendësimi i trotuareve të prishura me material cilësorë që përmirëson hapsirën publike dhe rrit cilësinë e shërbimit ndaj qytetarëve.

Shpenzimet korrente u kryen për të realizuar produktet:

I .Mirëmbajtja e Rrugëve urbane

- Përfshihet mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me asfaltobeton, riparimi i gropave të krijuara,duke vendosur puseta. Këtu do të ndërhyhet në disa akse rrugore, sipas nevojës.

Sipërfaqja totale e rrugëve është 857 km në të gjithë territorin e Bashkisë, nga të cilat 615 km janë me cakull dhe 242 km janë me asfalt. Sipërfaqja totale e rrugëve është 857,323 m² në të gjithë territorin e Bashkisë, nga të cilat janë të trajtuara me asfalt dhe 3,000 m² me stabilizant.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- Mirëmbajtje e urave në territorin e Bashkisë Berat, gjithsej 13 ura.

1. Mirëmbajtje e Rrugëve me kalldrëm dhe e trotuareve

Mirëmbajtja e rrugëve ekzistuese me kalldrem dhe shtimi i sipërfaqeve të reja . Gjithsej kemi 80,942 m² të mirëmbajtura gjatë vitit 2020.

Riparime të kalldrëmeve ekzistues:

✓ Ara e Kullaut	rreth 120 m ² .
✓ Rruga Agron Elezi	rreth 50 m ² .
✓ Rruga Shyqyri Fuga	rreth 25 m ² .
✓ Rruga Iljaz Vrioni	rreth 10 m ² .
✓ Rruga Aqilini Stamo	rreth 16 m ² .
✓ Rruga Veri Zaloshnja	rreth 6 m ² .
✓ Rruga Konstandin Kocaku	rreth 150m ²
✓ Rrugë të reja me kalldrëm	rreth 150 m ² në rrugën Kostandin Kristoforidhi

1. Rikonstrukcion dhe ndërtim i mureve guri mbajtës të rrugëve:

✓ Rruga Lemi Shamatase	180 m ³
✓ Rruga Gaqi Gjika	30 m ³
✓ Rruga Toli Bajaxhiu	16 m ³
✓ Rruga Veri Zaloshnja	8 m ³
✓ Rruha Shyqyri Fuga	2 m ³ dhe 25 m ² kalldrëm dhe ndërtimi shkallë betoni.
✓ Rruga Uzgurlliu	30 m ³
✓ Rruga Berberi	7 m ³
✓ Rruga hyrëse e Bilcës	22 m ³ dhe 7 tombino fi 1500
✓ Rruga Xhovan Doga	35 m ³

2. Mirëmbajtja e shesheve :

✓ Sheshi ‘ Xhimitiku ‘	85 m ² me asfalt
✓ Sheshi ‘ Kumsalla ‘	80 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Sallabanda ‘	900 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Tabia ‘	800 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Shen Gjergji ‘	1000 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Akropoli ‘	6500 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Kostandin i Madh’	800 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Onufri ‘	60 m ² me kalldrëm
✓ Sheshi ‘ Fusha e Madhe ‘	2300 m ² me kalldrëm

Sheshet janë mirëmbajtur për kalldrëmet, barërat, kanalet anësore, trotuaret, etj.

3. Mirëmbajtje rrugë me çakull :

- ✓ në lagjen Uznovë u krye shërbimi i mirembajtjes së rrugëve si më poshtë :

Emri rruges te trajtuar	njesia	siperf totale	siperfaqe trajtuar	gjatesi rruge totale
Rruga Avni deshnic	m ²	1400	500.00	196
Rruga Avni Kondi	m ²	4350	1,500.00	800
Rruga Kristaq Sinjari	m ²	110	500.00	280
Rruga Qemal Stafa	m ²	2640	800.00	361



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Rruga Mino Xhindi	m ²	330	-	52
Rruga Vojo Kushi	m ²	2424	700.00	480
Rruga Skenderbeu	m ²	1750	700.00	350
Rrga Sami Frasheri	m ²	2870	500.00	380
Shuma		15874	5,200.00	2899

- ✓ Në lagjen 30 Vjetori u skarifikuan dhe sistemuan rrugë me sipërfaqe rreth 200 m²
- ✓ Në lagjen Kushtrim u skarifikuan dhe sistemuan rrugë me sipërfaqe rreth 600 m²

4. Dizinfektimi i ambienteve dhe pastrim në territorin e Bashkisë Berat, shkolla, trotuare, sheshe, lulishte, etj.

Janë përdorur rreth 6500 litra solucione dizinfektimi, larguar rreth 400 m³ dhera, janë pastruar rreth 7500 m², janë kryer dizinfektime të rreth 15,000 m² ambientesh të hapura, etj.

5. Mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore

Përfshihet mirëmbajtje e sinjalistikës rrugore horizontale dhe vertikale në rrugët e qytetit dhe fshatrave, duke kryer të gjitha proceset e punës për mirëmbajtjen, aplikimin e vizatimeve trafikndarës dhe të këmbësorëve, për mirëmbajtjen e sinjalistikës vertikale, tabelave rrugore etj.

- ✓ Vijëzimi i vijave të bardha të këmbësorëve dhe vijave trafikndarëse
- ✓ Viza këmbësorësh me përmasa 3 x 0.5 m, në total 1398 m²
- ✓ Vijëzimi i vijave gjatësore trafikndarëse me gjerësi 12 cm, në total 400 ml
- ✓ Vijëzimi i vijave të bardha të këmbësorëve me përmasa 3 x 0.5 m, në total 200 m² në rrugët:
- Rruga Antipatrea (Shkolla Zihni Toska – shkolla 22 Tetori)
- ✓ Vijëzimi i vijave gjatësore trafik ndarëse me gjerësi 12 cm, në total 100 ml, në rrugët :
- Rruga Antipatrea (Shkolla Zihni Toska – shkolla 22 Tetori)

II . Mirëmbajtja e sistemit të kanalizimeve të ujërave të bardha , të larta dhe i pusetave

- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të bardha rreth 350 ml tubacione të dimensioneve të ndryshme,
- Mirëmbajtja e 40 pusetave dhe ndërtimi i 15 pusetave të reja
- Zgara të vogla ekzistuese në Njesitë Admin. Nr. 1 , nr. 2 , nr. 3.
- Mirëmbajtja dhe pastrimi i kanalizimeve të ujërave të larta në 6 zgara pritëse të medha në të gjithë territorin e bashkisë. Pastrimi i përrrenjve: Përroi i Suelasit , Përroi Pusi me Cati , Përroi i MCR.

III . Mirëmbajtja e rrugëve rurale me çakull (Inventari i rrugëve sipas VKM nr 915 dt 11.11.2015):

Rruga Rabjak – Karkanjoz 3 km; Rruga Levan – Sinjë 5 km; rruga Kamçisht-Paftal 2 km, Rruga Velabisht-Palikësht, Mbreshtan 5 km (pastrim gurësh të rënë); Rruga Mbreshtan – Paftal, Sinjë 12 km (pastrim gurësh të rënë); Rruga Velabisht – Gjoroven –Veleshnje – Molisht – 10 km; Rruga Roshnik i Vogël-Qafa e Pazgjanit – 2 km; Rruga Velabisht – Starovë, Remanicë, Vetterrik 7 km (pastrim kanalesh, pastrim bankinash); Rrugë të brendshme të fshatit Orizaj – 3 km; Rrugë të brendshme të fshatit Otllak, Rrugë të brendshme Moravë Rruga Hatillarëve) 2 km; Rruga Dushnik Qereshnik – 7 km.

- ✓ Mirëmbajtje e rrugëve me çakull:

Nr	Emri i rruges te trajtuar	njesia	siperf totale	siperfaqe trajtuar	gjatesi rruge trajtuar
1	Rruga Karkanjos mirëmbajtje 5 km	m ²	20 000	8 000	2 000



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

2	Rruga Roshniku Gjitollarë 2.4 km	m ²	8 800	2 000	500
3	Rruga e Kostrenit (Korçë) 5 km	m ²	15 000	7 000	2 300
4	Rruga e Vojnikut 2.2 km	m ²	6 600	3 000	1 000
5	Rruga Velabisht, Gjoreven Molisht 12 km	m ²	48 000	19 000	4 750
6	Rruga Bilçë Malinat 12 km	m ²	36 000	21 000	7 500
7	Rruga e Bogdanit	m ²	18000	8000	2000
8	Rruga Sinjë Levan km7	m ²	16000	7000	2200
9	Rruga Sinjë Osmëzezë	m ²	45000	16000	5000
10	Moravë	m ²	500	250	80

✓ Shtrim rrugë me beton :

- Njësia Administrative Otllak : (rruga e burgut) shtrim me beton 500 m2 dhe hedhje beton 70 m3
- Njësia Administrative Velabisht: Shtrim rrugë me beton 300 m2 dhe 37 m3 beton
- Rajoni Nr.3: Shtrim me beton rruga Konstandin Berati 1000 m2 dhe është hedhur beton 120m3

Realizimi i buxhetit të programit 04520 Rrjeti rrugor është 86,6%, fakt 64,546,000 lekë/plan 74,505,000 lekë

Realizimi i buxhetit të programit 04520 për vitin 2020 , në 000 lekë :

Emri i Grupit	Ndermarrja e Shërbimeve Publike							Kodi i Grupit	
Programi	4520							Kodi i Programit	
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(6) Fakti i 12- mujeve	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit	
600	Paga	37,148	38,266	38,266	38,266	35,310	-2,956	92.3%	
601	Sigurime Shoqërore	6,011	6,327	6,327	6,327	5,894	-433	93.2%	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	4,678	29,461	29,461	29,550	22,992	-6,558	77.8%	
603	Subvencione								
604	Transferta Korente të Brendshme								
605	Transferta Korente të Huaja								
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	83	80	80	110	98	-12	89%	
Nen-Totali	Shpenzime Korrente								
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara	1,599	252	252	252	252	0	100%	
232	Transferta Kapitalë								
Nen - Totali	Shpenzime Kapitalë me financim të brendshëm								
230	Kapitale të Patrupëzuara								
231	Kapitale të Trupëzuara								
232	Transferta Kapitalë								
Nen - Totali	Shpenzime Kapitalë me financim të huaj								
Totali	Shpenzime Kapitalë								
Shpenzime nga Të ardhurat jashtë limiti									
Totali (korrente + kapitale + Shp nga të ardh.jashtë limiti)		49,519	74,386	74,386	74,505	64,546	-9,959	86.6%	

✓ **Artikulli 600+601**, shpenzime personeli është realizuar në masën 92.4% , fakt 41,204,000 lekë / plan 44,593,000 lekë, si rezultat i mospërdorimit të fondit të vecantë edhe për arsye të raporteve mjekësore nga Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

punonjësit gjatë kësaj periudhe, si edhe për arsye të lëvizjeve të emërimeve dhe largimeve dhe vendeve vakante. Janë derdhur rregullisht kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, tatimi mbi të ardhurat personale duke mos krijuar borxhe pranë organeve tatimore.

Fond i vecantë për shpërblime dalje në pension dhe raste fatkeqësie është përdorur në shumën 98,000 lekë, për dy raste dalje në pension dhe një rast fatkeqësie.

✓ **Artikulli 602+609**, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes janë realizuar në masën 78% , fakt 22,992,000 lekë / plan 29,550,000 lekë.

✓ **(6020) Materiale zyre dhe të përgjithshme**

Është realizuar zëri kancelari në vlerën 120,000 lekë dhe është kryer likuidimi i plotë.

Është realizuar zëri blerje dokumentacioni në vlerën 80,000 lekë dhe është kryer likuidimi i plotë.

✓ Është realizuar zëri blerje vegla pune në vlerën 120,000 lekë dhe është kryer likuidimi i plotë.

(6021) Materiale dhe shërbime speciale

Është realizuar zëri blerje veshje pune në vlerën 120,000 lekë dhe është kryer likuidimi i plotë.

✓ **(6022) Shërbime nga të tretët**

Furnizimi me ujë - Janë shlyer faturat e ujit në mënyrë të rregullt në shumën 75,567 lekë.

Shërbim i internetit - Janë shlyer në mënyrë të rregullt faturat për shërbim internet në shumën 42,996 lekë.

✓ **(6023) Shpenzime transporti**

Në zërin karburant, nga kontrata e vitit 2019 kemi detyrime të papaguara vlerën 4015601 leke . Për këtë periudhe 12 –mujore kemi shlyer faturat e karburantit 8,015,978 lekë .

Në vitin 2020 është lidhur kontrata e re në vlerën 8,167,792 lekë. Kemi realizuar vlerën prej 6,156,484 lekë si 12 mujor. Kjo vlerë e faturuar është e palikujduar për mungesë celje fondi pasi kontrata është nga të ardhurat.

Duke filluar nga Janari 2020 janë bërë hyrje karburanti sasia prej 51817 litra.

Nga kontrata e vitit 2019 është bërë furnizimi prej 13917 litra nga Janari deri në 16.05.2020.

Nga kontrata e vitit 2020 janë realizuar në vlerën prej 6156484 lekë dhe në litra sasia prej 42900 litra si 12 mujor . Mbetur detyrime të papaguar në zërin karburant si 12 mujor vlera prej 4,544,651 lekë.

Në zërin pjesë këmbimi , goma bateri është lidhur kontrata e re për vitin 2020. Janë shlyer detyrimet e vitit të mëparshëm në vlerën e plotë prej 796800 lekë. Gjithashtu është paguar kontrata e cila është realizuar 100% në vitin 2020 në vlerën prej 2409420 lekë

Është realizuar prokurimi për vajra dhe lubrifikant në shumën prej 316160 leke. Fatura e pa likujduar.

Jane paguar detyrimi i siguracioneve për vitin 2019 në vlerën 174000 lekë

Është lidhur kontrata e vitit 2020 në vlerën 174000 lekë për siguracion mjetesesh. Janë likujduar siguracione mjetesesh në vlerën 352347 leke, të vitit 2019 dhe 2020.

(6025) Shpenzime mirëmbajtje

Janë prokuruar Materiale ndërtimi 2020, është lidhur kontrata në vlerën 9,678,252 lekë, e cila është realizuar dhe likujduar në vlerën prej 6,999,948 lekë.

✓ **Artikulli 230-231** Nuk janë realizuar Investime për vitin 2020 . Është kryer pagesë e detyrimit të vitit 2019 për blerje paisje elektronike, shuma 252,000 lekë :

Programi 6440 : NDRIÇIMI PUBLIK

Objektivat e Programit

Ofrimi me cilësi të lartë i shërbimit të ndriçimit të rrugëve në rajonet dhe njësitë administrative të bashkisë, mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues i ndiçimit publik dhe mbulimi i zonave të reja me ndiçim.

Produktet që synohen të ofrohen

I . Mirëmbajtja e ndriçimit rrugor

- Mirëmbajtja e rrjetit të ndriçimit rrugor ekzistues ku përfshihen punimet për mirëmbajtje të rrjetit të Raporti i monitorimit të zbatimit të buxhetit vjetor 2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

ndriçimit rrugor në rrugët e qytetit dhe fshatrave , riparime ditore, si rezultat i dëmtimeve dhe defekteve në linjat përkatëse, në një gjatësi të ndicuar prej 46.4km.

- Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndriçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndriçuesi ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
- Programe manaxhimi dhe ekonomizimi të energjisë elektrike nëpërmjet zëvendësimit të llampave ekzistuese me llampa ekonomike led.
- Shtim i gjatësive të ndricuara në masen 3 km (nga keto 2 km do plotesohen me blerjen e ndricuesve te rinj dhe 1 km nga heqja e ndricuesve te vjeter).
- Rikonstruksioni i rrjetit të ndriçimit rrugor në rrugët të cilat kanë pasur ndriçim rrugor, por sot nuk funksionon për shkak të dëmtimit të rrjetit, ku parashikohen punimet për vendosjen e koka ndriçuesi ose llamba, rrjeti kabllor i nevojshëm, etj.
- Shtimi i ndricimit (Zevendesuar me ndricim te ri) vendosje linjë e re në rrugën e Zamos, gjatësia gjithsej 1.1 km ndricim.
- Eshte bere zevendesimi i linjës së ndricimit në lulishten e Qytetit të Beratit .
- Ne rrugen nga Ypsiloni deri tek Varrezat e Dëshmorëve është bërë zëvendesimi i kokave te ndricuesve led.
- Ne fshatin Lapardha 2 u bë ndricim i ri 1.5 km rruge . me 31 cop ndricuesa.
- Eshte bere zevendesimi i llambave ne lagjet e Beratit ku ka paraqitur difekte.
- Në fshatin Orize u vendosen 34 copë ndricues të rinj.

Në vitin 2020 janë mirëmbajtur linjat elektrike si më poshtë:

- Rruga Shëtitore Osumi në lagjen 22 Tetori
- Rruga Rilindja në lagjen Kushtrim
- Rruga kryesore Antipatrea
- Rugicat në lagjen Mangalem
- Bulevardi Republika segmenti Stadiumi i ri Stadiumi i vjeter. etj
- Lagjja 13 Shtatori
- Lagjja Kala
- Rruga Shëtitore Osumi në lagjen 30 Vjetori
- Rruga Pavarësia, etj.

Vendosje llamba ndriçimi në të gjithë qytetin, sipas kërkesave.

Realizimi i buxhetit të programit 06440 Ndrim rrugësh është 81%, fakt 31,702,000 lekë/plan 39,341,000 lekë

Realizimi i buxhetit të Programit 06440 paraqitet si më poshtë, në 000 lekë :

Emri i Grupit	Ndermarrja e Sherbimeve Publike					Kodi i Grupit		
Programi	6440					Kodi i Programit		
Art.	Emertimi	(1) Fakti i vitit paraardhe Viti 2019	(2) PBA Plan Viti 2020	(3) Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	(4) Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	(6) Fakti Periudhes/12 muji	(7)=(6)-(5) Diferenca	% e realizimit
600	Paga	1,094	1,830	1,830	1,830	1,680	-150	92%
601	Sigurime Shoqërore	280	303	303	303	255	-48	84%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	19,539	32,548	32,548	37,208	29,767	-7,441	80%
603	Subvencione							
604	Transferta Korente të Brendshme							
605	Transferta Korente të Huaja							
606	Trans per Buxh. Fam. & Indiv							



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Nen-Totali	Shpenzime Korrente							
230	Kapitale të Patrupëzuara							
231	Kapitale të Trupëzuara							
232	Transferta Kapitale							
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem							
230	Kapitale të Patrupëzuara							
231	Kapitale të Trupëzuara							
232	Transferta Kapitale							
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj							
Totali	Shpenzime Kapitale							
	Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti							
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		20,913	34,681	34,681	39,341	31,702	-7,639	81%

Shpenzimet korrente në programin 6440 u kryen për të realizuar aktivitetet:

- ✓ Realizimi i pageses se pagave dhe te sigurimeve shoqerore per punonjesit e Ndermarrjes në masën 91 %, fakt 1,935,000 lekë / plan 2,133,000 lekë .
- ✓ Realizimi i shërbimeve nga të tretët (mirëmbajtje, energji elektrike, ujë,internet)
- ✓ Mirëmbajtja, rrjetit elektrik, mirëmbajtjes se zakonshme të rrugëve , trotuareve, ujërat e bardha.
- ✓ Realizimi i shpenzimeve të tjera operative.

Janë likujduar rregullisht faturat e OSHE në vlerën 29647048 lekë për 12-mujorin 2020. Janë likujduar dhe detyrimet e muajit Tetor 2019 dhe Nëntor 2019 të cilat ishin si detyrime te prapambetura.

Mbetet detyrim ndaj oshee prej 3,380,140 lekë, detyrim në vite për kamatvonesë.

Janë kryer procedurat e prokurimit për blerje materiale elektrike, është lidhur kontrata për vitin 2020 në vlerën prej 8,397,000 lekë. Është realizuar kontrata 100% në vlerën prej 8,397,000 lekë . Faturat janë të palikujduara për arsye mungese fondi nga mosrealizimi i të ardhurave.

- **Detyrimet e prapambetura** : Ndërmarrja e Shërbimeve në mbyllje të vitit buxhetor 2020 deklaroi detyrime të prapambetura në shumën 16,486,540 lekë të përbërë nga detyrime ndaj OSHE gjopa të mbartura nga vitet e mëparshme, fatura për blerje materiale ndërtimi dhe karburant.

NJËSIA SHPENZUESE : NDËRMARRJA E GJELBËRIMIT

Menaxhon 4 % të buxhetit të bashkisë , në një program :

1. Programi 06260 : Shërbime publike vendore

Realizimi në total i buxhetit 2020 për Ndërmarrjen e Gjellbërimit në 000 lekë

Tit. Progr	Emërtimi i Programit	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
	Ndërmarrja e Gjellbërimit	36,301	42,394	42,394	42,394	34,433	7,961	81.2%
06260	Shërbimet publike vendore	36,301	42,394	42,394	42,394	34,433	7,961	81.2%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Programi 06260 : SHËRBIME PUBLIKE VENDORE

Politika e këtij programi është përmirësimi i kushteve mjedisore dhe hapësirave të përbashkëta komunitare sa më të këndshme dhe funksionale, sipas standarteve bashkëkohore, krijimit të një ambienti shlodhës dhe argëtues për të gjallëruar jetën komunitare dhe kohezionin social.

Objektivat e Programit për vitin 2020 :

- Përmirësim i cilësisë së mirëmbajtjes dhe zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbra dhe gjelbërimit rrugor, në të gjithë territorin e Bashkisë
- Përmirësim i cilësisë së mirëmbajtjes dhe estetikës dhe kushteve të argëtimit për fëmijet e familjet
- Planifikim i përmirësimit dhe zhvillimit të strukturave si: rekreacioni, hapësirat e përbashkëta dhe relaksuese për komunitetin;
- Mbjellja e luleve, shkurreve dhe pemëve dekorative, të cilat përmirësojnë hapësirën e gjelbër të bashkisë
- Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike

• Treguesit e performancës në nivel rezultati (objektiva)

- ✓ Janë realizuar objektivat në masën 100% duke përmirësuar cilësinë dhe shtimin e sipërfaqeve të gjelbrt me lule, pemë dekorative, stola etj.

• Treguesit e performancës në nivel qëllimi

- ✓ Realizimi i qëllimeve të synuara
- ✓ Rritja e numrit të qytetarëve të kënaqur me shërbimin
- ✓ Ulja e ankesave të komunitetit të shërbimit
- ✓ Shtimi i i numrit të shërbimeve dhe pëlqimeve

Shpenzimet korrente u kryen për të realizuar produktet:

në 000 lekë

Kodi	Emërtimi i Treguesit të Performancës/Produktit	Njësia matëse	Sasia Faktike viti 2019	Shpenzimet viti 2019	Kosto per Njesi viti 2019	Sasia Faktike viti 2020	Shpenzi met Faktike viti 2020	Kosto per Njesi Faktike viti 2020
A	Kositja e barit	m2	70,336	6,022	0.1	70,336	7,963	0.1
B	Krasitja e pemëve	num er	5,000	2,671	0.5	5,000	6,200	1.2
C	Plehërimi dhe spërkatja	m2	1,000	3,450	3.5	1,000	3,300	3.3
D	Mbjellja e luleve	m2	6,000	3,100	0.5	6,000	4,200	0.7
E	Mirëmbajtja e stolave	cope	450	1,728	3.8	450	150	0.3
F	Ndërtim stolash	cope	53	742	14.0	53	0	0.0
G	Pastrimi i mbeturinave	m3	1,300	3,408	2.6	1,300	4,300	3.3
H	Mbjellja e pemëve	cope	990	5,081	5.1	990	1,620	1.6
I	Prashitja	m2	13,000	3,601	0.3	13,000	2,500	0.2
J	Vaditja	m2	70,000	6,500	0.1	70,000	4,200	0.1
Totali				36,302			34,433	

- ✓ Kryerjen e të gjitha proceseve teknologjike të punës si punim toke, vaditje, prashitje, krasitje, plehërim, pastrim, grumbullim mbeturinash etj. në një sipërfaqe të gjelbër prej 93.253 m2, ku nga kjo 16.804 m2 është sipërfaqe rrugë e sheshe, 70.336 m2 është sipërfaqe bar (tapete), 4.821 m2 sipërfaqe lule.
- ✓ Plehërimi i drurëve dekorative 750 cope me pleh kimik Dap 2.9 kv me vlerë 1700 lekë
- ✓ Plehërimi i sipërfaqeve me lule 6.000 m2 me pleh kimik Nitrat 2.5 kv me vlerë 1536 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

- ✓ Mirëmbajtje e gjithë inventarit të përfshirë në sipërfaqet e gjelbëra si pllaka me zaje, kosha mbeturinash, ndiçuesa, çezma zbukuruese, kënde lojërash për fëmijë, e kënde argëtuese për moshat e treta, lapidarë, buste, skulptura ku zakonisht janë harxhuar shpenzime materiale si; detergjentë materiale pastrimi, fshesa për fshirjen e rrugicave të lulishteve si dhe materiale të tjera në vlerë 32.828 lekë.
- ✓ Gjatë këtij 12 mujori është shpenzuar 1.890 litra naftë në vlerë 236177 lekë dhe benzinë 500 litra në vlerë 72625 lekë. Karburanti është shpenzuar për proceset e punës si: kositje bari me motokorrëse, prerje pemë me motosharrë, vaditje, heqje mbeturinash në të gjitha sipërfaqet e gjelbra me automjetet.
- ✓ Realizimi i pagesës së pagave dhe të sigurimeve shoqërore për nënpunësit dhe punonjësit e Ndërmarrjes së Gjelbërimit, në masën 99% gjithsej punonjës 55 vetë të ndare sipas strukturës administrata ka 7 punonjës, 10 punëtorë mirëmbajtës dekorativë, 10 punëtorë krasitës e kositës, 25 lulishtarë, 1 roje dhe 2 shoferë. Mosrealizim mbetet fondi i vecante si dhe diferenca e pagave për shkak të shkurtimit në strukturë të tre punonjësve, një specialist jurist, 1 roje, dhe 1 shofer.
- ✓ Shpenzimet operative janë realizuar në masën 99 % të planit vjetor.

Tabela e shpenzimeve 12 mujore të artikullit 602 paraqitet si me poshtë:

Llog.ek.sipas klasif.buxhetor	Emertimi	Plani vjetor fillestar	Plani vjetor korrigjuar	Fakti 12-mujori
602	Mallra dhe shërb. të tjera	5,282,000	5282000	3497160
6020	mat. zyre dhe të përgj.	120,000	120000	83228
6020100	Kanceleri	50,000	50000	41628
6020200	mat.per pastrim			0
6020300	mat.per funksion. Pajis .te zyrës	50,000	50000	41600
6020500	blerje dokumentacioni	20,000	20000	0
6021	Materiale dhe shërbime speciale	1,798,040	1,798040	1698454
6021001	veshje cpeciale	100,000	100000	94356
6021002	Pl.kim, fur.v, far, fid.te the. Prod. Agr..	1,244,040	1,244,040	1240508
6021008	Mat. Mbr.tokens, bimeve nga semundjet	62,000	62,000	51590
6021099	te tjera material	392,000	392000	312000
6022	Sherbime nga të tretet	300,000	300,000	296693
6022001	energji elek	150,000	150,000	149900
6022002	Uje	85,000	85,000	81793
6022004	shp.post	5,000	5,000	5,000
6022099	te tj shërb.int	60,000	60,000	60000
6023	shpenzime transporti	2,883,960	2883960	1358985
6023100	karburant dhe vaj	2,244,430	2244430	848455
6023200	pj.kembimi,goma ,bateri	489,530	489530	388920
6023300	shpenz. Te sigurac.te mjet.Transp	150,000	150000	121.610
6025	shpenz. Per mirembajt te zakonsh.	180,000	180000	59800
6025500	shpenz. Mirmb. Pajis.tek.vegla pune	60,000	60,000	598000
6025600	shpenz.per mirmb.mjetet e transp	120,000	120000	0

Gjatë vitit 2020 janë realizuar prokurimet me vlerë të vogël duke respektuar regjistrin e prokurimit si:

- ✓ Shërbim interneti me vlerë 60.000 lek , i realizuar në muajin janar.
- ✓ Materiale për pajisjet e zyrës (tonera) me vlerë 41.600 lekë
- ✓ Blerje materiale ndërtimi me vlerë 312.000 lekë
- ✓ Siguracë e automjeteve me vlerë 67.705 lekë
- ✓ Blerje plehëra farë bari fidanë me vlerë 621508 lekë
- ✓ Blerje kancelari me vlerë 41628 lekë
- ✓ Blerje pjesë këmbimi në vlerë 199560 lekë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Buxheti i programit 06260 është realizuar në masën 81%, fakt 34,433,000 lekë / plan 42,394,000 lekë.

Realizimit i buxhetit të Programit 06260 së Ndërmarrjes së Gjellbërimit, në 000 lekë

								% e reali zimit			
Emri i Grupit	Shërbime publike vendore								Kodi i Grupit		
Programi		06260							Kodi i Programit		
Art.		Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)		(7)=(6)-(5)		
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti Vjetor Viti 2020	Diferenca				
600	Paga	27,558	28,787	28,787	28,787	26,139	-2,648	90.8%			
601	Sigurime Shoqërore	4,658	4,760	4,760	4,760	4,360	-400	91.6%			
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	3,894	5,282	5,282	5,282	3,497	-1,785	66.2%			
603	Subvencione						0				
604	Transf. Korente të Brendshme						0				
605	Transferta Korente të Huaja						0				
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	41.75	200.00	200	200	197.50	-3	98.8%			
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	36,152	39,029	39,029	39,029	34,194	-4,836	87.6%			
230	Kapitale të Patrupëzuara						0				
231	Kapitale të Trupëzuara	149.6	3,365	3,365	3,365	239.7	-3,125	7.1%			
232	Transferta Kapitale										
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	150	3,365	3,365	3,365	240	-3,125	7.1%			
230	Kapitale të Patrupëzuara						0				
231	Kapitale të Trupëzuara						0				
232	Transferta Kapitale						0				
Nen -Totali	Shp. Kapitale me financim te huaj						0				
Totali	Shpenzime Kapitale	150	3,365	3,365	3,365	240	-3,125	7.1%			
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti											
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		36,301	42,394	42,394	42,394	34,433	-7,961	81.2%			

• **Detyrimet e prapambetura** : Gjatë vitit 2020 janë likuaduar të gjitha detyrimet e prapambetura nga viti 2019 në shumën 1,152,830 lekë.

Ndërmarrja e Gjellbërimit e mbyll vitin 2020 me 0 detyrime të prapambetura.

NJËSIA SHPENZUESE : DREJTORIA E ARSIMIT

Menaxhon 26% të buxhetit të bashkisë, në 5 programe :

1. Programi 01110: Planifikim, menaxhim dhe administrim
2. Programi 09120: Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor
3. Programi 09230: Arsimi i mesëm i pergjithshëm
4. Programi 09240: Arsimi profesional
5. Programi 10430: Kujdesi social për familjet dhe fëmijët



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

Realizimi në total i buxhetit 2020 për Drejtorinë e Arsimit (4 programe)

në 000 lekë

Tit. Progr	Emërtimi i Programit	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit paraardhës Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
	Drejtoria Arsimore Bashkia Berat	254,508	279,040	279,040	298,247	230,143	68,104	77.2%
01110	Planifikim, menaxhim dhe administrim	8,809	10,586	10,586	10,586	8,575	2,011	81.0%
09120	Arsimi bazë përfshirë arsimin parashkollor	165,435	195,233	195,233	195,268	171,679	23,589	87.9%
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm	13,146	13,579	13,579	13,817	13,049	768	94.4%
09240	Arsimi profesional	44,139	27,374	27,374	46,308	12,112	34,196	26.2%
10430	Kujdesi social për familjet dhe fëmijët	22,979	32,268	32,268	32,268	24,728	7,540	76.6%

Realizimi i buxhetit të vitit 2020 për Njësinë Shpenzuese Drejtoria e Arsimit është në masën 77,2%, fakti 230,143,000 lekë / plani 298,247,000 lekë

Realizimi i buxhetit 2020 sipas ndarjes ekonomike, Drejtoria e Arsimit, në 000 lekë :

								% e realizi mit
Njesia	Drejtoria e Arsimit Bashkia Berat							
Kodi i institucionit	E konsoliduar							
Art.	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(6)	(7)=(6)-(5)	
		Fakti i vitit paraardhes Viti 2019	PBA Plan Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2020	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2020	Fakti viti 2020	Diferenca	
600	Paga	170,526	180,645	180,645	180,473	171,453	9,020	95.0%
601	Sigurime Shoqërore	28,491	29,869	29,869	29,869	28,705	1,164	96.1%
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	28,316	64,980	64,980	84,187	26,491	57,696	31.5%
603	Subvencione	0	0	0	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0	0	0	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0	0	0	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	329	546	546	719	603	116	83.9%
Nen-Totali	Shpenzime Korrente	227,662	276,040	276,040	295,247	227,252	67,995	77.0%
230	Kapitale të Patrupezuara	0	0	0	0	0	0	
231	Kapitale të Trupezuara	26,846	3,000	3,000	3,000	2,890	110	96.3%
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te brendshem	26,846	3,000	3,000	3,000	2,890	110	96.3%
230	Kapitale të Patrupezuara	0	0	0	0	0	0	
231	Kapitale të Trupezuara	0	0	0	0	0	0	
232	Transferta Kapitale	0	0	0	0	0	0	
Nen -Totali	Shpenzime Kapitale me financim te huaj	0	0	0	0	0	0	
Totali	Shpenzime Kapitale	26,846	3,000	3,000	3,000	2,890	110	96.3%
Shpenzime nga Të ardhurat jashte limiti (Kap. 6)		0	0	0	0	0	0	
Totali (korrente + kapitale + Shp nga te ardh.jashte limiti)		254,508	279,040	279,040	298,247	230,142	68,105	77.2%



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA BERAT

Realizimi i buxhetit të shpenzimeve korrente është në masën 77%, fakt 227,252,000 lekë / plan 227,252,000 lekë
Realizimi i buxhetit të shpenzimeve kapitale është në masën 96,3 %, fakt 2,890,000 lekë / plan 3,000,000 lekë
Realizimi i buxhetit total të Njesisë Shpenzuese Drejtoria e Arsimit është në masën 77,2%, fakt 230,142,000 lekë / plan 298,247,000 lekë.

Drejtoria e Arsimit, Bashkia Berat ka si program kryesor pune veprimtarinë ekonomike, financiare dhe atë të shërbimit në mirëmbajtjen e kopshteve, cerdheve dhe shkollave 9-vjecare, të mesme të përgjithshme dhe profesionale që janë brenda teritorrit dhe juridiksionit të Bashkisë Berat.

Disa nga objektivat e plan buxhetit të vitit 2020 janë:

- Përbushja me sukses e të gjitha detyrimeve ligjore në fushën e arsimit
- Synimi i përbushjes së standarteve të miratuara nga M.A.SH në Strategjinë e Arsimit
- Përmirësimi dhe rritja e efektivitetit në cilësinë e shërbimeve ndaj institucioneve arsimore si dhe në forcimin e kontrollit të fondeve të planifikuara në buxhetin e arsimit
- Kontrolli i servirjes dhe cilësisë së menisë ushqimore për fëmijët në kopshte, cerdhe dhe konvikte
- Realizimi i mirëmbajtjes së kopshteve, cerdheve, konviktit dhe shkollave të qytetit, duke synuar në përbushjen e standarteve optimale në ambientet e mësimdhënies

Ndër objektivat e realizuara për këtë vit në Institucionet Arsimore dhe të kujdesit për fëmijët janë si më poshtë:

CERDHE

■ 1-Çerdhja nr 1 , Lagja "30 Vjetori"

Janë kryer punime si : sigurim i plotë i ngrohjes së ambientit, mirëmbajtje e kaldajës dhe furnizim me naftë. Sigurimi i ujit të ngrohtë në dushe. Riparime elektrike, marangozi dhe punime në nyjet sanitare. Lyerje të pjesshme me bojë vaji.

■ 2-Çerdhja nr 7, Lagja Donika Kastrioti .

Janë kryer punime mirëmbajtje të zakonshme; hidraulike, elektrike, marangozi.

KOPSHTET

■ 1-Kopshti " Uznove + cerdhe "

Furnizim me soba te reja, lavatrice, detergjente, termometer infrared dhe materiale pastrimi. Sigurimi i ngrohjes se ujit dhe ambjentit. Lyerje e tualeteve, anekseve , grupeve dhe pjeserisht fasades se kopshtit. Punime mirembajtjeje, riparime ne nyjet sanitare, fuqizim i rrjetit te ndricimit, riparime te dyerve dhe dritareve. Montim i stolave te rinj dhe riparim i atyre ekszistues ne oborrin e kopshtit.

■ 2-Kopshti " D.Kastriot "

Lyerje te pjesshme te fasades dhe murit rrethues te kopshtit. Riparime dhe vendosje materialesh hidraulike ne nyjet sanitare. Nderhyrje ne rrjetin elektrik, zevendesim i prizave dhe celsave te demtuar, fuqizim i sistemit ndricues. Riparime te dritareve, dyerve, karrikeve, tavolinave te femijeve dhe rafteve. Furnizim me soba te reja, dru zjarri, montim i dusheve te rinj dhe sigurimi i ujit te ngrohte ne tualetet e kopshtit per cdo grup femijesh. Riparimi i stolave ne ambjentet e jashtme dhe kendit te lojrave.

■ 3- Kopshti " 10 Korriku "

Suvatime te pjesshme dhe lyerje totale e godines perfshire ambjentet e brendshme dhe fasadat. Mobilim e shtreter te rinj, furnizim me soba te reja,lavatrice, dushe per ujin e ngrohte, materiale didaktike, materiale pastrimi, termometer infrared dhe dezinfektant. Rehabilitim i rrjetit hidraulik dhe kanalizimeve duke



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA BERAT

shmangur lageshtine ne objekt. Riparime hidraulike, elektrike, dyer, dritare, rafte, tavolina, karrike, etj. Sistemim i oborrit dhe lulishtes, vendosje e stolave te rinj dhe riparimi i atyre ekzistues.

■ 4- Kopshti “ 1 Qershori”

Riparime te catise, suvatime dhe elemimin i lageshtise ne fasade dhe grupe te kopshtit. Lyerje totale e godines (fasade dhe ambjentet e brendshme). Sigurimi i ambjentit te ngrohje dhe ujit te ngrohje per cdo grup. Sistemim i territorit, Riparim dhe lyerje te stolave jashte. Punime te zakonshme mirembajtjeje , hidraulike, marangozi dhe elektrike.

■ 5-Kopshti ” Clirim Nr 1”

Jane bere lyerje dhe rifinitura te pjesshme te brezave te murit ne dhomat e fjetjes.

Jane bere riparime te dyerve, dritare, tavolina, rafte etj.,

Jane bere riparime hidraulike ne nyjet H/S

Jane pastruar shkarueset e ujrave te catise

Jane pastruar oxhaket dhe është siguruar ngrohje e vazhdueshme.

Jane lyer kangjellat rrethuese te kopshtit me boje vaji

Jane bere dekorime me blloqe dhe jane montuar 2 stola ne ambjentin jashte.

Eshte siguruar uji i ngrohje (dushe te rinj), ngrohja e vazhdueshme gjate dimrit dhe te gjithë solucionet e nevojshme per higjenen ne kushtet e Covid -19.

eshte bere mobilimi me shtreter te rinj

■ 6-Kopshti” Clirim Nr 2”

Jane bere te gjitha sherbimet hidraulike, elektrike, riparime nga marangozi.

Jane lyer grupet e femijeve

Jane bere riparime te stolave dhe lyerje e tyre.

Eshte siguruar uji i ngrohje dhe i rrjedhshem ne te gjithë tualetet.

Eshte siguruar mjaftueshem sasia e druve per ngrohjen e kopshtit gjate dimrit.

Jane pajisur me te gjitha mjetet e dezinfektimit, pastrimit dhe termometra ne kuader te Covid –19

■ 7-Kopshti ”Barikade 2+3 dhe cerdhe nr. 5”

Janë kryer vazhdimisht të gjitha shërbimet hidraulike, elektrike dhe marangozi. Është siguruar uji i rrjedhshëm, uji i ngrohtë dhe ngrohja gjatë periudhës së dimrit duke furnizuar plotësisht me dru. Furnizim me detergjentë, materiale pastrimi, lavatrice të re, termometër infrared.

■ 8-Kopshti “Barikade e Re.(Llambrini Puli)”

Kopshti është në gjendje shumë të mirë.

Është kryer një rikostruksion total nga UNDP si dhe është furnizuar me materiale didaktike.

Janë bërë ndërhyrje të shpeshta në fasade si pasojë e demtimit të saj nga femije te lagjes.

Jane bere zhbllokime te kanalizimeve dhe sistemim i territorit ne pjesen e kendit te lojërave.

Jane bere riparime te dritareve dhe vendosje xhamash ne katin e pare.

Jane bere të gjitha sherbimet hidraulike, elektrike dhe riparime nga marangozi.

■ 9-Kopshti ”28 Nentori”

Eshte bere mirembajtja e kopshtit si , riparime hidraulike, riparim i disa dyerve dhe dritareve si dhe punime elektrike.

U montuan profile per varjen e rrobave ne ballkonet e kopshtit.

Jane zevendesuar dhe riparuar pllakat e thyera ne tarracen e katit te trete. U bene lyerje dhe stukime te parapeteve dhe ballkoneve.

U zevendesuan ulluqet e demtuar dhe u bene riparime te pjesshme ne catine e kopshtit. Jane lyer grupe ne katin e pare dhe te dyte, korridore dhe ballkone.

U bene suvatime te pjesshme te fasades se pasme si edhe lyerje dhe stukime ne te 4 anet e fasades se



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

kopshtit.

U be dezinfektimi me gelqere i murit rrethues.

